

BANKA E SHQIPËRISË

MBIKËQYRJA BANKARE
RAPORTI VJETOR 2002

Qershor 2003

PËRMBAJTJA

1. **HYRJE**
2. **AMBIENTI BANKAR**
 - 2.1. *Karakteristikat e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2002*
 - 2.2. *Ndryshimet ligjore që ndikojnë në mbikëqyrjen bankare*
 - 2.3. *Procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve*
3. **MISIONI I MBIKËQYRJES BANKARE**
4. **FUNKSIONET E MBIKËQYRJES BANKARE**
 - 4.1 *Analiza e sistemit bankar*
 - 4.2 *Inspektimet në vend dhe masat korrektuese*
 - 4.3 *Licencimi dhe rregullimet bankare*
 - 4.4 *Plani afatmesëm i zhvillimit të Departamentit të Mbikëqyrjes*
5. **LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË**
 - 5.1. *Banka dhe degë të bankave të huaja*
 - 5.2. *Subjekte jobanka*
 - 5.3. *Zyra të këmbimeve valutore*
6. **LISTA E RREGULLOREVE TË MBIKËQYRJES BANKARE NË FUQI DERI NË QERSHOR TË VITIT 2003**

1. **HYRJE**

I nderuar lexues,

Gjatë vitit 2002, Departamenti i Mbikëqyrjes ka bërë hapa pozitivë në drejtim të rritjes së profesionalizmit në punë, të shoqëruara edhe me zhvillime të rëndësishme në drejtim të standardizimit të procesit të punës, përmirësimit të kuadrit rregullativ nëpërmjet vjeljes së një mendimi me bazë më të gjerë, rritjes së objektivitetit në gjykim dhe përdorimit të teknikave më të sofistikuara dhe bashkëkohore në drejtim të identifikimit të rreziqeve dhe të marrjes së masave paraprake për parandalimin e tyre.

Më konkretisht, edhe gjatë vitit 2002 sistemi bankar shqiptar ka qenë vazhdimisht nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet mbikëqyrjes në vend edhe nëpërmjet analizave së rreziqeve të ndërmarra nga bankat. Mbikëqyrja në vend, duke qenë në qendër të procesit të mbikëqyrjes, është realizuar përmes ekzaminimeve të plota në vend dhe në këtë kontekst çdo bankë e sistemit është inspektuar të paktën një herë në vit, por edhe nëpërmjet ekzaminimeve tematike, marrë shkas nga analizat për çdo bankë ndërmjet dy periudhave dhe rekomandimeve të lëna për t'u zbatuar. Natyrisht, theksi i vëmendjes në punën e departamentit ka qenë i orientuar tek sistemi bankar, pasi bankat luajnë një rol kyç në sistemin financiar dhe ekonominë kombëtare të një vendi dhe paraqesin një interes të veçantë për publikun e gjërë i cili iu beson atyre kursimet e veta.

Në përmbushjen e misionit tonë kryesor për të patur një sistem financiar dhe veçanërisht bankar të shëndetshëm dhe të sigurtë, jemi përpjekur të arrijmë një ekuilibër ndërmjet sigurisë për një administrim dhe drejtim të kujdesshëm të bankave nga njëra anë dhe rritjes së efektivitetit të tyre në anën tjetër. Në këtë kuptim, jemi të ndërgjegjshëm që pavarësisht se sistemi bankar paraqitet i qëndrueshëm, nuk është detyrë e autoritetit mbikëqyrës që të parandalojë çdo problem në sistemin bankar me pasoja edhe falimentin e ndonjë banke, por para së gjithash parandalimi i një pjese të madhe të tyre dhe në rastin më të keq heqja nga tregu, në momentin e duhur, të bankave që keqdrejtohen dhe keqadministrohen duke inkurajuar bankat e tjera të përmirësojnë administrimin.

Duhet theksuar se volumi i punës ka njohur rritje në krahasim me vitet e mëparshme. Krahas programit rutinë është punuar paralelisht me sukses edhe për realizimin e pjesës më të madhe të detyrave të Planit të Zhvillimit të Mbikëqyrjes në bashkëpunim me Bankën Botërore. Megjithëkëtë, një proverbë kineze na kujton se “Në një udhëtim prej njëqind miljesh, nëntëdhjetë janë vetëm gjysma e rrugës” dhe unë besoj që miljet e fundit të një maratone janë më të vështirat për t’u kryer.

Mbikëqyrja bankare është vlerësuar pozitivisht edhe nga institucionet ndërkombëtare, si Banka Botërore e Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në përfundim të kësaj parathënieje, të nderuar lexues, ndaj me ju mendimin se interesat dhe misioni ynë si mbikëqyrës janë në harmoni me interesat tuaj për të patur një sistem bankar dhe financiar të qëndrueshëm. Në këtë kuptim, rritja e transparencës në punën tonë dhe të sistemit bankar në tërësi, kërkon edhe angazhimin tuaj për të ushtruar më me forcë disiplinën e tregut duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e besimit ndaj këtij sistemi dhe në krijimin e një klime më të favorshme për rritje ekonomike dhe mirëqënie.

Fatos IBRAHIMI
Zëvendësguvernator i parë

2. AMBIENTI BANKAR

2.1. Karakteristikat e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2002

Rritja ekonomike në Shqipëri për vitin 2002 u vlerësua 4.7 për qind. Në këtë rritje të produktit të brendshëm bruto ndikuan aktivitetet në degën e transportit, të shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërkohë që sektori publik vazhdoi të evidentojë peshën e tij në rënie.

Në të vërtetë, ekonomia shqiptare për vitin 2002 prezantoi ritmin më të ulët rritës në krahasim me periudhën 1998-2001, pasojë kjo e një niveli më të ulët të investimeve të huaja dhe shpenzimeve kapitale, ndërsa të gjitha degët e ekonomisë manifestuan ritme rritjeje më të ulta se parashikimet.

Gjatë vitit 2002, janë evidentuar ndryshime të strukturës së ekonomisë shqiptare. Kjo ngjarje lidhet me rënien e peshës së bujqësisë dhe të blegtorisë në ekonomi, ndërsa rritet kontributi i degës së tregtisë dhe të shërbimeve. Këto ndryshime strukturore konsiderohen pozitive për të ardhmen e një vendi, ndërkohë që duhet t'i jepet përparësi nxitjes së prodhimit industrial. Ky i fundit u rrit vetëm me 2 për qind, duke evidentuar ritmin më të ulët rritës në krahasim me degët e tjera të ekonomisë. Është e qartë se dega e industrisë është ndikuar më tepër nga problemet e energjisë elektrike, të cilat janë prezente për një periudhë disavjeçare në Shqipëri.

Sidoqoftë, ekonomia shqiptare ka përjetuar rritje për të pestin vit rradhazi, gjë që ka dhënë ndikimin e vet në rritjen e të ardhurave për frymë. Kështu, për vitin 2002 të ardhurat për frymë të llogaritura si raport i PBB-së në dollarë me popullsinë e vendit vlerësohen rreth 1500 dollarë amerikanë.

Norma vjetore e inflacionit për fundvitin 2002 ishte 2.1 për qind. Kjo normë konsiderohet në nivele relativisht të ulta dhe brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Ecuria e ekonomisë shqiptare në vitin 2002 nuk mund të përjashtohet nga ndikimet e ngadalësimit të përgjithshëm të ekonomisë botërore, sidomos të problemeve që shoqëruan ekonominë e rajonit.

2.2. Ndryshimet ligjore që ndikojnë në mbikëqyrjen bankare

Pas diskutimeve të mbingarkuara teknike dhe politike, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave". Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë sigurimin dhe kompensimin e depozitave në rastet e falimentimit të bankave, si dhe të përcaktojë mënyrën e krijimit, përgjegjësitë dhe veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Krijimi i sistemit të sigurimit të depozitave është një hap i rëndësishëm që do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e sistemit bankar. Sigurimi i depozitave ofron mbrojtje për depozituesit, sidomos për kursimet e individëve dhe të biznesit të vogël. Në këtë mënyrë, edhe në rastin e falimentimit të bankës, këtyre të fundit do t'u kthehet e gjitha ose një pjesë e konsiderueshme e depozitës.

Ligji "Për sigurimin e depozitave" përcakton nivelin e depozitës që sigurohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, deri në 700 mijë lekë. Pjesa e depozitës deri në 350 mijë lekë sigurohet në masën 100 për qind, ndërsa pjesa e mbetur deri në 700 mijë lekë sigurohet në masën 85 për qind.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.8893, datë 14.05.2002 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998. Shtesat dhe ndryshimet konsistojnë kryesisht në detyrimet që burojnë nga neni 161 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, si edhe në disa shtesa dhe ndryshime të tjera, të cilat evidentojnë dhe garantojnë nga pikëpamja politiko-legjislative pavarësinë e Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e politikës monetare.

Rritja e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës është mjaft e rëndësishme për një vendimmarrje të pavarur nga qëndrimet politike dhe ato të qeverisë lidhur me sistemin bankar .

Ndryshimet dhe shtesat kryesore që ka sjellë ligji i ri janë si vijon:

Me nenin 3 të ligjit të ri, është shtuar shprehja "e pavarur" në pikën 4 të nenit 3, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997. Shtesa që është bërë ndikon në rritjen e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë në procesin e zbatimit të politikës monetare, si një nga detyrat kryesore të saj që ia njuh ligji.

Me nenin 4 të ligjit të ri është shtuar një pikë e veçantë, me të cilën i jepet e drejta Bankës së Shqipërisë që të përdorë në mënyrë të pavarur mjetet (instrumentet) e politikës monetare me të cilat ajo realizon objektivin kryesor të saj, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si dhe të objektivave të tjerë të politikës monetare.

Me nenin 5 të ligjit të ri është bërë një ndryshim tjetër që buron nga pika 2 e nenit 161 të Kushtetutës dhe ka të bëjë me mënyrën e zgjedhjes dhe të emërimit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Ndërsa në nenin e shfuqizuar Guvernatori propozohej nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe emërohej nga Presidenti, me ligjin e ri Guvernatori propozohet nga Presidenti i Republikës dhe zgjidhet e emërohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Ky ndryshim i zgjedhjes së Guvernatorit nga Kuvendi bëhet në përputhje me raportet institucionale të Bankës së Shqipërisë me Kuvendin, të përcaktuara në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë".

Me nenin 6 të ligjit të ri, është bërë një shtesë në nenin 46 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, e cila konsiston në shmangien e konfliktit të interesit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Në këtë shtesë përcaktohet papajtueshmëria e funksionit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me atë të punonjësit, të administratorit dhe të aksionerit me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë. Në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”,¹ Këshilli Mbikëqyrës merr vendime që janë të lidhura direkt me interesat e atyre subjekteve, që kryejnë veprimtari bankare dhe financiare në bazë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, vendime që fillojnë që nga marrja e licencës, miratimi i akteve rregullative të mbikëqyrjes, dhe deri tek revokimi i licencës. Me anë të kësaj shtese, sigurohet plotësisht eliminimi i konfliktit të interesave të këtij funksioni të lartë të Bankës së Shqipërisë me çdo emërtesë apo pozicion pune në një bankë të nivelit të dytë apo subjekte financiare jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, apo me funksionet e tjera të larta shtetërore, të përmendura në paragrafin e parë të nenit 46 të ligjit.

Me nenin 7 të ligjit të ri është ndryshuar pika 1 e nenit 63 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, si një detyrim që buron nga neni 161 i Kushtetutës. Me këtë ndryshim, përcaktohet detyrimi i Bankës së Shqipërisë që të mbajë dhe të administrojë jo vetëm rezervën e saj valutore (siç ishte neni i ndryshuar), por të gjithë rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë, si dhe komponentët përbërës të kësaj rezerve, të cilët me ligjin e ri nuk pësojnë ndryshime.

2.3. Procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve

Stabiliteti i sektorit bankar, si një faktor udhëheqës i stabilitetit financiar në çdo vend dhe një kusht i rëndësishëm për plotësimin me sukses të ristrukturimit të ekonomisë si ekonomi tregu, është reforma dhe ristrukturimi i sistemit bankar . Objektivat e reformës për këtë periudhë janë :

- reduktimi i pozicionit dominues në treg i Bankës së Kursimeve;
- përfundimi i procesit të ristrukturimit të saj;
- privatizimi që do të realizojë transformimin e pronës shtetërore në pronësi private.

Privatizimi do të rrisë efektivitetin e sistemit bankar.

Nga analiza e Bankës së Kursimeve në drejtim të masave të marra për privatizim dhe në këtë kuadër për zbutjen e pozitës dominuese të saj, gjatë vitit 2002 janë evidentuar si më specifike masat e mëposhtme:

- i) transferimi i të gjitha shërbimeve të pensioneve nga Banka e Kursimeve tek Posta Shqiptare sh.a. (deri në fund të marsit 2003);
- ii) përpjekje të mëtejshme për zhvendosjen e shërbimeve të buxhetit të shtetit nga Banka e Kursimeve në banka të tjera;

¹ Shiko nenin 43 gërma “c” dhe gërma ”e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

- iii) konsolidimi i mëtejshëm i degëve të Bankës së Kursimeve në zonat rurale;
- iv) përsosja e rrjetit informatik të bankës;
- v) fillimi i procesit për ndërtimin e kapaciteteve të kredidhënies.

Lidhur me privatizimin e Bankës së Kursimeve, aksioneri i kësaj banke, Ministria e Financave, ka përgatitur një plan veprimesh për ristrukturimin e saj, për periudhën dhjetor 2002–shtator 2003. Ky plan konsiston në zhvillimin e mëtejshëm të informatizimit, në reduktimin dhe ngritjen profesionale të stafit, në kalimin e shërbimeve fiskale, në ristrukturimin e rrjetit të bankës, në përmirësimin e sistemit të pagesave, në shtrirjen rajonale të bankës, në reduktimin e dominancës së bankës dhe marketingun.

3. MISIONI I MBIKËQYRJES BANKARE

Funksioni i mbikëqyrjes bankare ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore dhe autoritet mbikëqyrës, në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të ligjit “ Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Ndër detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë është të licencojë ose të revokojë licencën e bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre bankare, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar.

Misioni i mbikëqyrjes bankare² është:

- të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar dhe të mbrojë interesat e depozituesve dhe të publikut në tërësi;
- të sigurojë një sistem bankar të shëndoshë, aktiviteti i të cilit të jetë transparent dhe i udhëhequr drejt ekonomisë së tregut;
- të rrisë besimin e depozituesve dhe biznesit nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të industrisë bankare dhe efektivitetit të saj.

Roli i mbikëqyrjes bankare është:

- të sigurojë, nëpërmjet procesit të licencimit, hyrjen në tregun bankar, vetëm të subjekteve të kualifikuara (aksionerë dhe administratorë) që plotësojnë kërkesat përkatëse ligjore, profesionale dhe etike, që kanë kapital të mjaftueshëm për ndërmarrjen e rrezikut, si dhe politika dhe procedura për kontrollin e rrezikut;
- të sigurojë që bankat të veprojnë në mënyrë të shëndoshë duke zbatuar kërkesat ligjore dhe rregullative, që ato të kenë kapitalin e mjaftueshëm, likuiditetin e nevojshëm, cilësi të kënaqshme të aktiveve, rezerva të mjaftueshme për të përballuar rreziqet që kanë ndërmarrë, administrim sipas standardeve ndërkombëtare “të praktikave më të mira”, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e klientit dhe të evitojë praktikat abuzive;
- të sigurojë që bankat me probleme të trajtohen shpejt dhe me efektivitet në mënyrë që të mbrohen depozituesit, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë ekzistuese, minimizimin e kostos së qeverisë dhe të publikut.

Për të përmbushur këtë rol mbikëqyrja bankare:

- harton dhe rishikon rregulloret lidhur me: hyrjet e reja në sistemin bankar, kryerjen e një veprimtarie të kujdesshme bankare, monitorimin e rezultateve

² Mitaruar me vendim nr. 37, datë 22.05.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

të arritura, kujdestarinë dhe likuidimin e bankave, dhe imponon zbatimin e akteve ligjore dhe rregullative;

- harton politika aktive dhe strategji për mbikëqyrjen e bankave të veçanta dhe të sistemit bankar në tërësi, që janë të bazuara në vlerësimin e drejtimit të rrezikut;
- zhvillon procedura mbikëqyrëse sipas udhëzimeve dhe standardeve ndërkombëtare;
- zbaton këto procedura, standarde dhe udhëzime në vazhdimësi;
- siguron mjaftueshmërinë e stafit në numër dhe në cilësi, për të realizuar mbikëqyrjen e industrisë bankare;
- financon dhe merr pjesë në takime të rregullta me industrinë bankare dhe me autoritete të tjera mbikëqyrëse, për probleme me interes të përbashkët.


4. FUNKSIONET E MBIKËQYRJES BANKARE

4.1. ANALIZA E SISTEMIT BANKAR

4.1.1. Struktura e sistemit bankar

Tregu bankar edhe në fund të vitit 2002 përbëhet nga 13 banka, 1 bankë me kapital shtetëror (banka më e madhe e sistemit), 2 banka me kapital të përbashkët dhe 10 banka me kapital privat (përfshirë 3 degë të bankave të huaja). Në vitin 2002 u licencua edhe një bankë e re me kapital privat, Banka e Kreditit të Shqipërisë.

Figurë 1. Struktura e sistemit bankar sipas pronësisë së kapitalit.



Bankat zgjeruan rrjetin e aktivitetit të tyre nëpërmjet hapjes së degëve të reja dhe disa prej tyre prezantuan produkte të reja, si: ATM (Automatic Teller Machine), kartat e kreditit, çertifikatat e depozitave, kreditë konsumatore, kontratat e së ardhmes (forward), etj. Gjatë vitit 2002 u hapën 9 degë banke dhe 1 agjenci bankare.

Tabelë 1. Shpërndarja gjeografike e sistemit bankar në fund të vitit 2002.

Nr	Emri i bankës	Numri i punonjësve	Numri i degëve	Rrethi ku është hapur	Numri i agjencive	Rrethi
1.	BK	1 283	37	Berat, Kuçovë, Çorovodë, Bilisht, Burrel, Durrës, Elbasan, Gramsh, Peqin, Fier, Ballsh, Gjirokastër, Tepelenë, Kavajë, Korçë, Ersekë, Krujë, Kukës, Krum, Laç, Rrëshen, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Përmet, Peshkopi, Bulqizë, Pogradec, Sarandë, Delvinë, Shkodër, Koplik, Pukë, Bajram Curri, Tirana 1, Tirana 2, Vlorë.	91	Berat, Kuçovë, Çorovodë, Bilisht, Burrel, Durrës, Elbasan, Gramsh, Peqin, Fier, Ballsh, Gjirokastër, Tepelenë, Kavajë, Korçë, Ersekë, Krujë, Kukës, Krum, Laç, Rrëshen, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Përmet, Peshkopi, Bulqizë, Pogradec, Sarandë, Delvinë, Shkodër, Koplik, Pukë, Bajram Curri, Tirana 1, Tirana 2, Vlorë.
2.	BKT	226	10	Tiranë(3),Durrës,Gjirokastër, El-basan, Korçë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë.		
3.	BISH	72			3	Tiranë, Durrës, Vlorë.
4.	BASHI	43	1	Shkodër		
5.	BD	11				
6.	BT	160	11	Tiranë(4), Durrës, Fier, Gjirokastër, Elbasan, Korçë, Shkodër,Vlorë.		
7.	BKG-dega Tiranë	58			3	Tiranë, Durrës, Korçë.
8.	BTN	35	1	Tiranë.		
9.	BA-dega Tiranë	51	5	Tiranë,Durrës,Gjirokastër,Elb a-san, Berat.		
10	BASH	151	2	Durrës,Vlorë.		
11	FEFAD	171	7	Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Vlorë.	1	Tiranë.
12	BPI-dega Tiranë	13				
13	BTG (AL)	39				

4.1.2 Aktivitet e sistemit, struktura dhe cilësia e tyre.

Aktivitet e sistemit bankar janë rritur me 20,9 miliardë lekë ose 6,5 për qind nga fundviti 2001. Ndërsa gjatë këtij të fundit, totali i aktiveve të sistemit bankar u rrit për 17,6 për qind ose 46,7 miliardë lekë, duhet të përmendim se shkak i ritmit më të ulët rritës për vitin 2002, është ngjarja e tërheqjes së konsiderueshme të depozitave nga Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare gjatë muajve mars-prill. Kështu, ndërsa në muajin shkurt totali i aktiveve të sistemit u rrit për 7,3 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2001, në muajin mars rënia llogaritet 7,6 miliardë lekë krahasuar me muajin shkurt dhe 385,6 milionë lekë krahasuar me fundvitin. Në muajin prill evidentohet tërheqje më e madhe e depozitave nga këto banka, e cila jep efekt në një rënie të totalit të aktiveve të sistemit bankar në muajin qershor për 3,9 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2001. Ndërkohë, është muaji gusht në të cilin sistemi bankar prezanton rritje krahasuar me fundvitin, rritje kjo që vazhdon të shfaqet edhe në muajt e tjerë të vitit 2002.


Tabelë 2. Totali i aktiveve, ecuria në vite.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02
Totali i aktiveve	249.5	270.8	318.5	339.3
Në përqindje ndaj PBB	49.2	50.2	53.5	51.6

Në analizën sipas grupbankave të sistemit, grupi i bankave me kapital shtetëror evidenton rënie të totalit të aktiveve për 4,9 miliardë lekë, grupi i bankave me kapital të përbashkët një rritje për 447 milionë lekë, ndërkohë që rritja në grupin e bankave me kapital privat është 25.4 miliardë lekë, gjë që konfirmon rëndësinë e këtij të fundit në rritjen e aktiveve të sistemit bankar gjatë vitit 2002.

Zgjerimi i aktivitetit të bankave private ka bërë deri-diku të krahasueshme peshën e këtij grupi me grupin e bankave me kapital shtetëror (40,3 për qind kundrejt 54,1 për qind) ndaj sistemit bankar.


Figurë 2. Peshë e grupbankave në vite në sistemin bankar (sipas totalit të aktiveve).



Aktiviteti kreditues.

Gjatë vitit 2002, kreditimi nga sistemi bankar prezantohet gjithnjë në rritje. Kështu, ndërsa fundviti 2002 prezantoi rritje të tepricës së kredisë prej 37,7 për qind ose 10,7 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2001, muajt e tjerë të vitit, krahasuar me të njëjtën periudhë, shënuan rritjet si në grafikun e mëposhtëm:

Figurë 3. Ecuria e tepricës së kredisë (në milionë lekë).



Disa nga tiparet e kredihënies të shfaqura gjatë vitit 2002:

- *Prirja drejt kredisë afatgjatë.* Kredia afatgjatë përbën 7,6 për qind të tepricës së kredisë nga 5,4 për qind në fundvitin e kaluar. Ndërkohë, kredia afatshkurtër nga 55 për qind në fundvitin 2001, evidentohet 47,7 për qind e tepricës së kredisë në fundvitin 2002.
- *Rritja e kredisë së akorduar në lekë.* Në fundvitin 2002, teprica e kredisë në lekë përbën 21 për qind të tepricës gjithsej së kredisë, nga 18,3 për qind që evidentohet në fundvitin 2001.
- *Rritja e huamarrjes nga individët.* Individëve i përket rreth 19 për qind e tepricës së kredisë, nga 15,1 për qind në fundvitin 2001.

Cilësia e kreditimit.

Krahas rritjes sasiore të kredisë, do të konsiderojmë dhe cilësinë e saj. Si vlerësues të cilësisë së portofolit të kredisë marrim në konsideratë raportin e kredisë me probleme ndaj tepricës së kredisë. Ky tregues, i llogaritur mbi baza bruto, evidentohet 5,6 për qind në këtë fundvit, nga 6,9 për qind në fundvitin

2001. Përmirësimi i këtij raporti gjen shpjegim kryesisht në kredinë e re, që ka çuar në rritjen e tepricës së kredisë. Kështu, duke i vlerësuar të ndara efektet që kanë ndikuar në ndryshimin e raportit kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë prej 1,3 pikë përqindjeje, efekti i rritjes së tepricës së kredisë llogaritet 1,8 për qind dhe ai i rritjes së kredisë me probleme - 0,5 për qind. Duhet theksuar se teprica e kredisë është rritur 10,7 miliardë lekë gjatë vitit 2002, ndërsa teprica e kredisë me probleme është rritur 207 milionë lekë. Po kështu, raporti i kredisë me probleme ndaj tepricës së kredisë për neto evidentohet 2,8 për qind nga 4 për qind në fundvitin 2001.

Në përfundim, konkludojmë se cilësia e kredisë akorduar nga sistemi bankar prezanton nivel relativisht të kënaqshëm.

4.1.3. Ecuria e depozitave dhe e llogarive rrjedhëse.

Burimet nga të tretët apo depozitat janë burimi kryesor i fondeve në të cilat mbështeten aktualisht bankat për investimet e tyre. Një vështrim në bankat e sistemit duke konsideruar raportin e kapitalit aksioner ndaj depozitave evidenton pak banka që mbështeten më shumë në kapital se në burimet nga të tretët. Janë pikërisht bankat relativisht të reja dhe ato që nuk janë shtrirë shumë në kredidhënie³, të cilat prezantojnë nivele të larta të këtij raporti. Por, sistemi në tërësi vazhdon të mbështetet në burimet nga të tretët. Këto të fundit përbëjnë rreth 84 për qind të totalit të pasiveve, nga 86 për qind që përbënin në fund të vitit 2001.

Gjatë vitit 2002 ecuria e depozitave të sistemit, ndonëse pati një tkurrje në periudhën mars-prill, në dy tremujorët e fundit të vitit njohu një tendencë rritëse që kompensoi rënien e nivelit të depozitave në periudhën e mëparshme. Kështu, në krahasim me fundvitin 2001, niveli i depozitave të sistemit u rrit për 4 për qind ose 11,2 miliardë lekë.

Tabelë 3. Ecuria e depozitave dhe e llogarive rrjedhëse.

<i>Treguesi në milionë lekë</i>	<i>Dhjetor 2001</i>	<i>Mars 2002</i>	<i>Qershor 2002</i>	<i>Shtator 2002</i>	<i>Dhjetor 2002</i>
<i>Totali i depozitave & llogarive rrjedhëse</i>	277 818	270 700	265 082	279 626	289 006

Ndikimin kryesor në këtë rritje, krahasuar me fundvitin 2001, e dhanë bankat private (me rreth 19 miliardë lekë). Gjatë tremujorit të fundit të vitit, Banka e

³ Përrjashtim nga ky evidentim bën vetëm një bankë e G3, e cila investon më shumë se 50 për qind të aktiveve në kredidhënie duke u mbështetur në nivelet e kapitalit.

Kursimeve jep kontributin më të lartë në sistem (me 6,2 miliardë lekë) dhe pothuaj dy herë më të lartë se bankat private (me 3,1 miliardë lekë). Banka e Kursimeve vazhdon të ruajë peshën kryesore në depozitat e sistemit, ndonëse niveli i depozitave pranë kësaj banke, në fund të vitit 2002, nuk arrin nivelin e shënuar në fundvitin 2001⁴.

Tabelë 4. Pozicioni i Bankës së Kursimeve në aktivitetin depozitues të sistemit bankar.


Treguesi në % ndaj sistemit bankar	Dhjetor 2001	Mars 2002	Qershor 2002	Shtator 2002	Dhjetor 2002
Totali i depozitave & llogarive rrjedhëse	63.7	61.8	59.4	58.0	58.3

Struktura e depozitave të sistemit vazhdon të evidentojë nivelin më të lartë të depozitave në lekë (67,3 për qind), me afat (80 për qind) dhe të pranuar nga individët (85 për qind) në totalin e depozitave të sistemit. Ndërsa në dy klasifikimet e fundit, të gjitha grupet e bankave ndjekin tendencat e sistemit, në klasifikimin sipas monedhës është vetëm grupi i bankave shtetërore që dikton tendencën e sistemit për depozitat në lekë (rreth 74 për qind), ndërkohë që grupi i bankave me kapital të përbashkët dhe grupi i bankave private evidenton nivelin më të lartë të depozitave në valutë (rreth 73 për qind). Por, sistemi në tërësi i favorizuar dhe nga normat e interesit për depozitat në lekë prezantoi një rritje më të madhe të këtyre depozitave (8,5 miliardë lekë), përkundërsht depozitave në valutë që shënuan rritje më të ulët (2.6 miliardë lekë) krahasuar kjo me fundvitin 2001.


⁴ Niveli i depozitave në Bankën e Kursimeve në fund të vitit 2002 është 168 miliardë lekë, nga 177 miliardë lekë që evidentohet në fundvitin 2001.

Figurë 4. Struktura e depozitave të sistemit.


Figurë 4a. Sipas disponibilitetit.



Figurë 4b. Sipas sektorëve.



Figurë 4c. Sipas monedhës.



4.1.4 Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve, e ardhura neto.

Fitimet shihen si faktori kryesor i efektivitetit në institucionet financiare. Këto të fundit ndikohen në një masë më të madhe nga niveli i rrezikut që marrin mbi vete këto institucione. Preferohet rrezik jo shumë i lartë por fitime të qëndrueshme e me rritje të arsyeshme.

Në këtë fund viti, ndërsa gjendja e përgjithshme e sistemit bankar vlerësohet e mirë dhe me tregues rentabiliteti pothuaj në kufijtë normalë të tyre, për banka të veçanta ka akoma probleme në administrimin e mjeteve dhe të burimeve dhe, si rrjedhojë, dhe treguesit e rentabilitetit për këto banka paraqiten nën nivelin e sistemit.

E ardhura neto

Në fundvitin 2002 e ardhura neto (pas taksave) për sistemin bankar evidentohet rreth 3,9 miliardë lekë. Niveli i këtij treguesi krahasuar me fundvitin 2001 është më i ulët për 0,4 miliardë lekë ose 9.4 për qind.

Në rënien e të ardhurës neto (pas taksave) ka ndikuar grupi G1 (evidenton rënie në të ardhurën neto për 0,8 miliardë lekë) ndërkohë që dy grupet e tjera G2 dhe G3 prezantojnë rritje (për rreth 0,1 miliardë lekë dhe 0,3 miliardë lekë).

E ardhura neto nga veprimtaria kryesore e sistemit bankar (e ardhura neto nga interesat, komisionet, veprimtaria valutore etj.) krahasuar me fundvitin 2001 u rrit vetëm për 1.7 për qind, ndërkohë që shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë dhe fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë evidentojnë rritje për 14.4 për qind. Për grupbanka tendenca e treguesve të mësipërm paraqitet:

- Në G1, e ardhura neto nga veprimtaria kryesore evidenton rënie 12.2 për qind, ndërsa shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë dhe fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë, rritje për 27.9 për qind.
- Në G2, e ardhura neto nga veprimtaria kryesore është rritur 0.96 për qind, ndërkohë që shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë dhe fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë shfaqin ulje 8.5 për qind.
- Në G3, e ardhura neto nga veprimtaria kryesore evidenton rritje 20.3 për qind, ndërsa shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë dhe fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë, rritje për 14.7 për qind.

Në këtë fundviti vetëm një bankë e G3 evidenton humbje.

Tabelë 5. Të ardhurat dhe shpenzimet, e ardhura neto.

Treguesi milionë lekë	G1		G2		G3		Sistemi bankar			
	2001	2002	2001	2002	2001	2002	2001	2002		
1. Të ardhurat neto nga interesat	4,626.1	3,984.6	739.7	604.6	3,312.5	4,258.1	8,678.3	8,847.3		
Të ardhura nga interesat	14,834.1	14,747.1	1,088.8	961.7	6,487.9	7,829.3	22,410.8	23,538.1		
Shpenzime për interesa	10,208.0	10,762.5	349.1	357.1	3,175.4	3,571.2	13,732.5	14,690.8		
2. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera	1,065.6	1,012.5	317.1	462.3	986.7	915.6	2,369.4	2,390.5		
Të ardhura nga veprimtari të tjera	1,253.0	1,065.7	438.7	501.7	1,987.8	1,794.4	3,679.5	3,361.7		
Shpenzime për veprimtari të tjera	187.4	53.1	121.6	39.3	1,001.1	878.8	1,310.1	971.3		
3. Shpenzime për provigjone	-	99.9	98.3	541.9	381.1	237.8	241.1	679.8	720.5	
4. Të ardhura bruto të veprimtarisë	5,791.7	4,898.9	514.9	685.9	4,061.4	4,590.1	10,367.9	10,174.9		
5. Shpenzimet e veprimtarisë	1,749.6	2,011.7	482.3	555.6	2,564.8	2,974.9	4,796.8	5,542.3		
6. Të ardhura neto të veprimtarisë	4,042.0	2,887.1	32.5	130.2	1,496.6	1,615.2	5,571.1	4,632.6		
7. Rezultati neto i jashtëzakonshëm	-	39.9	-	20.2	-	3.8	-	11.9	53.3	31.4
8. Të ardhurat neto para taksave	4,002.2	2,867.0	28.7	118.3	1,549.8	1,989.1	5,580.7	4,974.3		
9. Taksa mbi të ardhurat	1,000.5	716.7	6.2	0.3	291.5	379.0	1,298.3	1,096.0		
10. E ardhura neto (pas taksave)	3,001.6	2,150.2	22.5	118.0	1,258.3	1,610.1	4,282.4	3,878.3		

Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat nga interesat japin kontributin kryesor në të ardhurën neto të sistemit bankar. Krahasuar me fundvitin 2001 këto të ardhura prezantojnë rritje 5 për qind, ndërkohë që bankat e G3 evidentojnë rritje, 20.7 për qind.

Të ardhurat nga interesat përfaqësojnë 84.2 për qind të totalit të të ardhurave. Të ardhurat kryesore (64.2 për qind të totalit të të ardhurave) janë interesat e arkëtuar nga investimet në letrat me vlerë (të Qeverisë Shqiptare dhe të tregjeve ndërkombëtare) dhe interesat e arkëtuar nga kredidhënia (10.7 për qind të totalit të të ardhurave). Kjo dukuri e sistemit evidentohet në bankat e G1 dhe G3 ndërsa në bankat e G2 të ardhurat kryesore janë interesat e arkëtuar nga kredidhënia (33.4 për qind të totalit të të ardhurave të grupit).

Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera zënë 12 për qind të totalit të të ardhurave. Të ardhurat kryesore të këtij grupi janë të ardhurat nga komisionet (6.7 për qind të totalit të të ardhurave) dhe nga veprimtaria valutore (3.9 për qind të totalit të të ardhurave).

Shpenzimet për interesa përfaqësojnë 61 për qind të totalit të shpenzimeve dhe janë rritur rreth 7 për qind nga fundviti 2001. Peshën kryesore e zënë interesat e paguar për llogaritë dhe depozitat e klientëve (57.8 për qind të totalit të shpenzimeve).

Analiza për grupbanka evidenton grupin G1 me nivel më të lartë të shpenzimeve për interesa (77.9 për qind të totalit të shpenzimeve të grupit) dhe që rrjedhin kryesisht nga interesat e paguar për klientët (74.9 për qind të totalit të shpenzimeve të grupit).

Në vitin 2002, shpenzimet për krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë janë rritur rreth 6 për qind krahasuar me fundvitin 2001, duke ndikuar kryesisht bankat e G2 (provigjonet e këtij grupi përbëjnë 52.9 për qind të provigjoneve të krijuara nga sistemi bankar).


Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë përfaqësojnë 19.4 për qind të totalit të shpenzimeve dhe janë rritur 15.5 për qind nga viti 2001. Janë bankat e G2 dhe G3 që evidentojnë peshë më të lartë të këtyre shpenzimeve në totalin e shpenzimeve të grupit përkatës.

Rritja e shpenzimeve të veprimtarisë i dedikohet zgjerimit të rrjetit bankar - hapjes së degëve dhe të agjencive të reja bankare si dhe përmirësimeve dhe rritjes së nivelit të teknologjisë dhe informacionit etj..


Treguesit e rentabilitetit

Rezultatet e politikave dhe të vendimeve administruese të institucioneve financiare dhe aftësitë e tyre në konvertimin e aktiveve në të ardhura neto, reflektohen në treguesit e rentabilitetit. E ndërsa ROA tregon aftësinë e institucionit për të operuar në tërësi me fitim, ROE tregon mundësinë e rritjes së investimeve. Këta tregues evidentohen brenda niveleve normale⁵.

Në këtë fundviti ROA, e cila llogaritet si raport i të ardhurës neto me aktivet mesatare, rezulton 1.2 për qind nga 1.5 për qind në fundvitin 2001. Në rënien e ROA ka ndikuar rënia e të ardhurës neto (9.4 për qind) dhe rritja e aktiveve mesatare (10 për qind). Në grupet G1 dhe G3 treguesi evidenton pothuaj të njëjtin nivel të sistemit, ndërkohë që në grupin G2 treguesi llogaritet 0.6 për qind. ROE rezulton 19.1 për qind nga 21.6 për qind në fundvitin 2001. Në G1 niveli i ROE është më i lartë se ai i sistemit bankar (47.6 për qind), ndërkohë që në të dyja grupet e tjera niveli i këtij treguesi është më i ulët se ai i sistemit (3.4 për qind dhe 13.1 për qind).




⁵ Niveli normal i ROA konsiderohet 0.5 – 1.6 për qind, ndërsa për ROE 10 - 20 për qind.



Marzhi neto i interesave, është treguesi më i rëndësishëm në administrimin e mjeteve dhe burimeve. Ky tregues nuk ndryshon nëse institucioni arrin të kontrollojë ndikimin e ndryshimit të normës së interesit. Në një mjedis me norma interesi të luhatshme, ndryshimi i madh i këtij treguesi shoqërohet me rrezik të lartë të normës së interesit.

Në këtë fundviti marzhi neto i interesave është reduktuar në krahasim me fundvitin 2001 (3⁶ për qind nga 3.3 për qind). Rënia evidentohet në të treja grupet e bankave, ndërkohë që G2 prezanton rënien më të lartë. Në reduktimin e këtij treguesi ka ndikuar rritja me ritme më të larta e aktiveve mesatare që sjellin të ardhura (14.7 për qind) se rritja e të ardhurës neto nga interesat (1.9 për qind).



⁶ Niveli normal i NIM konsiderohet 3 – 10 për qind.

4.1.5 Mjaftueshmëria e kapitalit, likuiditeti dhe ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut

a- *Analiza e kapitalit* - element mjaft i rëndësishëm në monitorimin e rreziqeve të një institucioni financiar (banke)⁷ dhe të sistemit bankar në tërësi, do të trajtojë ecurinë e dy treguesve kryesorë të levës financiare dhe të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Është i njohur fakti që sa më e madhe të jetë baza e kapitalit të një banke në raport me aktivet, aq më i vogël është rreziku i përgjithshëm. *Leva financiare* (kapitali i bankës/totali i aktiveve), - si tregues i strukturës së fondeve të një institucioni, i referohet pikërisht shkallës me të cilën pakësohet vlera e aktiveve të një banke përpara se të kërcënojnë depozituesit dhe kreditorët. Pra, sa më i lartë të jetë ky tregues, aq më e ulët është shkalla e rrezikut. Në fund të vitit 2002, ky tregues për sistemin bankar evidentohet 6.4 për qind, nga 5.9 për qind që evidentohet në fund të vitit 2001. Rritja e niveleve të levës financiare shpjegohet me ritmet më të larta të rritjes së kapitalit aksioner (15.3 për qind krahasuar me fundvitin), se ato të aktiveve të sistemit (6.6 për qind krahasuar me fundvitin), duke evidentuar kështu në vazhdimësi nivele të kënaqshme kapitali për sistemin.

*Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit*⁸, si treguesi kryesor që përcakton aftësitë e bankës për të përballuar humbjet e mundshme të saj, edhe në fund të vitit 2002 për sistemin bankar vazhdon të evidentojë një nivel relativisht të lartë prej 31.5 për qind, ndonëse krahasuar me vitin 2001 ky raport⁹ evidenton rënie.

Kapitali rregullator dhe aktivet e klasifikuara sipas rrezikut – si elemente të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, japin ndikim edhe në nivelet e këtij raporti. Kështu, ndërsa kapitali rregullator rritet me 6.9 për qind ose rreth 1.2 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2001, aktivet e klasifikuara sipas rrezikut relatojnë një rritje për 19.4 për qind ose rreth 9 miliardë lekë. Analiza sipas grupbankave evidenton grupin e bankave private me ndikimin kryesor në rënien e raportit të sistemit, të cilat po zgjerojnë shumë shtrirjen në aktivet me rrezik. Kështu, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për grupin e bankave me kapital privat evidenton nivelin më të ulët 28.9 për qind, për grupin e bankave me kapital shtetëror, 33.3

⁷ Ndonëse shumica e studimeve të bëra sugjerojnë që kapitali nuk përbën një mbrojtje të mjaftueshme ndaj rreziqeve, madje dhe nivele të larta kapitali shpesh janë të pamjaftueshme për të parandaluar falimentimin e një banke me probleme të mprehta. Shterimi i kapitalit është rezultati i fundit, i humbjeve të rezultuara nga rreziku i kreditimit të tepërt, normës së interesit, likuiditetit etj..

⁸ *Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit* jepet si raport i kapitalit rregullator ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me rrezikun.

⁹ **Tabelë: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave në fund të vitit 2001.**

Treguesi	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	35.3	29.9	40.4	35.7

për qind dhe për grupin e bankave me kapital të përbashkët, 43.6 për qind. Kjo vlerëson edhe një herë kontributin në rritje të bankave private në investimet më me rrezik, kontribut i cili parashikohet të jetë më i madh duke marrë në konsideratë kapacitetet e brendshme dhe nivelet e kënaqshme të kapitalit që kanë këto banka.

b- Analiza e treguesve kryesorë të likuiditetit *evidenton nivel të kënaqshëm të tij edhe për vitin 2002. Në analizën e likuiditetit do të vazhdojmë të marrim në konsideratë raportet e likuiditetit¹⁰ dhe gap-in e maturimit.*

Raportet e likuiditetit masin aftësinë e një banke për të përballuar nevojat në para me një humbje minimale të vlerës së mjeteve të saj. *Dihet që mospërmbushja e kërkesave të tilla mund të jetë shkatërrimtare për bankën dhe për sistemin në tërësi. Si burime likuide përdoren aktivet dhe pasivet, ndërkohë që bankat e vogla mbështeten më shumë në aktivet afatshkurtra dhe bankat e mëdha mbështeten më shumë tek pasivet.*

Bankat e sistemit vazhdojnë të evidentojnë një nivel të kënaqshëm të aktiveve likuide në totalin e aktiveve të tyre (mbi 37 për qind) si dhe një nivel mbi 100 për qind të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra¹¹.

Gap-i i maturimit deri në 1 muaj, që prezanton diferencën midis aktiveve me pasivet me maturim të mbetur deri në një muaj, ndonëse evidenton vlera negative për një pjesë të bankave, këto të fundit janë relativisht të pakonsiderueshme ndaj totalit të aktiveve.

Kështu, pavarësisht ngjarjeve të muajve mars-prill që tronditën likuiditetin e sistemit dhe që u përballuan me sukses nga lehtësirat e Bankës së Shqipërisë, në përgjithësi, sistemi evidenton një situatë të normalizuar dhe një nivel të kënaqshëm likuiditeti, që nuk e ekspozon atë ndjeshëm ndaj rrezikut të këtij të fundit.

c- Ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut.

Në analizën e ndjeshmërisë së sistemit bankar ndaj rreziqeve me të cilat mund të përballlet ai, merret në konsideratë *rreziku i humbjes nga kredia dhe rreziqet e tregut.*

Për vlerësimin e madhësisë së këtyre rreziqeve, si dhe për parandalimin e përkeqësimit të treguesve makroprudentë të sistemit bankar, shfrytëzohet një element mjaft i rëndësishëm i kësaj analize, i cili njihet me emrin Stress Tests. Ky

¹⁰ Këto raporte janë *aktive likuide ndaj totalit të aktiveve dhe aktive likuide ndaj pasiveve afatshkurtra.*

¹¹ Pasive afatshkurtra janë konsideruar: veprimet me thesarin dhe ndërbankare, depozitat pa afat, 10 për qind të llogarive rrjedhëse (90 për qind e llogarive rrjedhëse, sipas standardeve bashkëkohore konsiderohen fonde të veta për bankën, për shkak të natyrës së tyre "të patërheqshme").

i fundit ka të bëjë me ndjeshmërinë e treguesve makroprudentë ndaj ndryshimeve të konsiderueshme (*shocks*) makroekonomike. Objektivi i Stress Tests është që t'i bëjë rreziqet më transparente, nëpërmjet vlerësimit të humbjeve të mundshme në situatat më të rënda të supozuara.

Në këtë mënyrë, si *shock* (shok) për *rrezikun e kreditit*, i cili ka të bëjë me rrezikun e dështimit të të tretëve apo debitorëve në përmbushjen e detyrimeve të tyre kontraktuale, supozohet një rënie e konsiderueshme ekonomike. Kështu, shfrytëzohet ekuacioni i regresit i raportit “kredi me probleme / totali i aktiveve”¹² (për tërë sistemin bankar) me vlerën nominale të produktit të brendshëm bruto (PBB) të një tremujori më parë dhe llogaritjet koeficienti përkatës i korrelacionit. Rezultati i testit kur në ekuacion përdoret vlera *shock* e PBB-së, konfirmon vlerë të ulët të raportit “kredi me probleme / totali i aktiveve”.

Si rrjedhojë e modelit të mësipërm evidentohet madhësi modeste e ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut të kreditit.

Në vijim analizohen dy elemente të rëndësishme të rreziqeve të tregut, që janë “rreziku i kursit të këmbimit” dhe “rreziku i normës së interesit”, pasi “rreziku i çmimit të kapitaleve” dhe “rreziku i çmimeve të mallrave të tjera” nuk merren në konsideratë për vetë mosekzistencën e tyre tek ne.

Si *shock* për rrezikun e kursit të këmbimit (ky i fundit vlerësohet nëpërmjet pozicionit të hapur neto në valutë) konsiderohet zhvendosja e kurbës së kursit të këmbimit me 3 devijime standarde, për një nivel besueshmërie 99 për qind dhe frekuencë tremujore të këtij kursi, për periudhën dhjetor’98 – dhjetor’02. Në këtë mënyrë, pasi llogaritjet ky nënçmim/mbiçmim për dy monedhat kryesore që janë euro dhe usd, analizohen pasojat (humbjet) që mund të shkaktojnë pozicionet e hapura në këto monedha. Llogaritjet kryhen për bankat që prezantojnë vlera të larta të pozicioneve të hapura në këto monedha. Konkretisht, testet e fundit treguan se *bankat e sistemit, përgjithësisht, janë të mbrojtura nga luhatjet e kursit të këmbimit.*

Një metodë për vlerësimin e rrezikut të normës së interesit është ndryshimi në të ardhurat neto nga interesi për shkak të luhatjeve të normave të interesit.

Në këtë rast, si *shock* u përdor zhvendosja e kurbës së normës së interesit me 3 devijime standarde, për një nivel besueshmërie 99 për qind dhe frekuencë tremujore të normës së interesit të depozitave gjatë periudhës dhjetor’98 – dhjetor’02. Konkretisht, ky *shock* për fundvitin 2002 ishte ekuivalent me një rritje të normës së interesit prej 3.3 për qind. Mbas llogaritjes së mospërputhjes (gap-it) midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, aplikimi i *shock*-ut të mësipërm rezultoi në një humbje të përbalueshme nga sistemi bankar, gjë që flet për një ekspozim të kufizuar të sistemit edhe ndaj rrezikut të normës së interesit.

¹² Ky raport konsiderohet si matës i ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut të kreditit.

Tendenca dhe perspektiva të sistemit gjatë vitit 2003.

- Privatizimi me sukses i Bankës së Kursimeve – bankës së fundit shtetërore në sistem, do të shmangë dominimin e saj në tregun e depozitave dhe do të rrisë konkurrencën, pasi këtij tregu do t'i shtohet dhe një bankë e re private.
- Përmirësimi i strukturës së investimeve të bankave të sistemit sidomos në aktive më me rrezik kryesisht në kredidhënie, do të japë kontributin e vet në ekonomi.
- Rritja e të ardhurave të sistemit nga aktivitetet e tjera krahas atyre nga interesat dhe kjo kryesisht nga bankat private, do të kontribuojë në zgjerimin e aktivitetit bankar të sistemit në tërësi.
- Lehtësirat e ofruara për likuiditetin nga Banka e Shqipërisë do të kufizojnë ekspozimin e bankave të sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit.
- Nivelet e mjaftueshme të kapitalit do të prezantojnë bankat e sistemit të mbrojtura kryesisht nga rreziku i kredisë.
- Një mbikëqyrje bankare më efektive do të vazhdojë të sigurojë një sistem bankar të shëndoshë dhe mbrojtje të depozituesit.

4.2. Inspektimet në vend dhe masat korrektuese

Inspektimi në vend i bankave është një pjesë e rëndësishme e mbikëqyrjes bankare pasi bën ekzaminimin e atyre fushave, të cilat nuk mund të vlerësohen nga mbikëqyrja nga jashtë (analiza off site). Në mënyrë të veçantë, ai bën vlerësimin e nivelit të drejtimit dhe të administrimit të bankës, të procedurave që ndiqen për identifikimin, për monitorimin dhe për administrimin e rreziqeve, për sistemin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, inspektimet në vend luajnë një rol të rëndësishëm në saktësimin dhe në përmirësimin cilësor të të dhënave të raportuara në Bankën e Shqipërisë.

Inspektorët e mbikëqyrjes bankare e bazojnë punën e tyre në kontaktet me bankat e inspektuara. Këto kontakte, janë të rëndësishme për një zgjidhje pozitive të të gjitha problemeve të zbuluara gjatë ekzaminimit.

Realizimi i inspektimeve në vend bëhet në bazë të planit, të miratuar në fillim të vitit. Ai ka si synim kryerjen e inspektimeve të plota të të gjitha bankave. Ky program është i shoqëruar edhe me inspektime të pjeshme për probleme të veçanta që kanë dalë gjatë vitit.

Gjatë vitit 2002 u realizuan 13 inspektime të plota dhe 11 të pjeshme.

Ekzaminimi bankar në bankat e nivelit të dytë pati për qëllim të sigurohet për :

- I. Kryerjen nga bankat e një veprimtarie të sigurtë e të qëndrueshme.
- II. Identifikimin e bankave apo të veprimtarive bankare të veçanta, që kërkojnë vëmendjen e autoritetit të mbikëqyrjes.
- III. Vlerësimin e administrimit të bankave dhe plotësimin, miratimin dhe mbikëqyrjen nga këshillat drejtues, të akteve të brendshme të veprimtarisë së bankës si: politika, procedura etj..

Në përgjithësi, gjendja në sistemin bankar, e vlerësuar nga ekzaminimet në vend, paraqitet e mirë, gjë e cila është një element shumë i rëndësishëm për mbështetjen e ekonomisë në zhvillimet e saj.

Disa nga karakteristikat kryesore që u vunë re në sistemin bankar gjatë vitit 2002 janë:

1. Zgjerimi i aktivitetit kreditues, në disa banka është shoqëruar me rritjen e kredive me probleme. Kjo ka ardhur nga disa shkaqe ku do të veçonim si më kryesoret:
 - Fillimi i aktivitetit kreditues pa siguruar më parë një personel të përgatitur, për t'iu përgjigjur kërkesave të këtij sektori si dhe mungesa e eksperiencës për monitorimin e kredive.
 - Mosmbështetja në politika dhe në procedura të plota dhe të sakta.
 - Ekzistenca e një tregu jo në nivelin e duhur për t'iu përgjigjur detyrimeve të një kredimarrjeje, i cili akoma nuk është familjarizuar sa duhet me parimet e ekonomisë së tregut.
 - Situata e pastabilizuar në disa sektorë jetikë të ekonomisë, si ai i energjitikës.
 - Mosfunksionimi i aspekteve ligjore që kanë të bëjnë me procesin e kreditimit.

2. Është rikthyer besimi i publikut në sistemin bankar pas panikut që mbizotëroi në muajt prill – maj 2002 në Bankën e Kursimeve dhe në atë Kombëtare Tregtare. Gjendja e likuiditetit dhe, në përgjithësi, aktiviteti i këtyre bankave është përmirësuar ndjeshëm duke u rikthyer në rrjedhën normale.

Në sistemin bankar ka patur një gjendje likuiditeti të mirë, përgjithësisht si rezultat i investimit në zëra likuidë si: vendosje në bankat e tjera, në bono thesari të Qeverisë së Shqipërisë apo në letra me vlerë të qeverive të tjera të vendeve të zonës A.

3. Bankat vazhdojnë të zgjerojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet hapjes së degëve apo të agjencive të reja në qytete të ndryshme në jug dhe në veri të vendit, dhe në disa prej tyre vihet re një përpjekje për aplikimin e produkteve të reja bankare.
4. Drejtimi i lartë, në përgjithësi, ka reaguar pozitivisht ndaj problemeve të ngritura në ekzaminimet e kryera, por nuk ka treguar kujdesin e duhur për:
 - përmirësimin e politikave dhe të procedurave të aktivitetit të bankës;
 - plotësimin e kuadrit rregullativ të aktivitetit të bankës;
 - zbatimin e planbiznesit (në banka të veçanta evidentohen shmangie nga madhësia e fitimit, depozitave dhe investimeve të parashikuara në planbiznese).

Gjatë inspektimeve të kryera janë konstatuar gjetje, të cilat nuk janë në përputhje me praktikën e shëndosha bankare. Këto gjetje kanë qenë të natyrave të ndryshme si:

- Shkelje të ligjit “Për kontabilitetin” dhe moszbatim me korrektësi i “Manualit të kontabilitetit bankar” për mbajtjen e kontabilitetit dhe të rezultatit financiar në monedhën vendase.
- Shkelje të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, për mbajtjen e dokumentacionit dhe të korrespondencës në gjuhën shqipe.
- Shkelje të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, lidhur me ndarjen e pozicionit të anëtarit të komitetit të kontrollit nga pozicioni i anëtarit të komitetit të administrimit.
- Moszbatim me korrektësi të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, lidhur me rritjen e rolit të komitetit të kontrollit dhe të kontrollit të brendshëm të vetë bankës.
- Shkelje të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë si:
 - klasifikimi i portofolit të kredive jo në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për menaxhimin e riskut të kredisë”;
 - emërimi dhe fillimi nga detyra i disa administratorëve në disa banka pa marrë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë;
 - dokumentacioni përkatës që duhet të shoqërojë transfertat e kryera nga bankat nuk i përgjigjet kërkesave të rregullores nr. 12, datë 21.02.2001 “Për veprimtarinë valutore”.

Në varësi të shkeljeve të evidentuara, janë përcaktuar masat korrektuese ose ndëshkimore, mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Masat e zbatuara në vitin 2002 janë:

- rekomandime apo sugjerime për të korrigjuar parregullsitë e vogla;
- kërkesa për të paraqitur në Bankën e Shqipërisë një program masash për rregullimin e gjendjes së bankës, në rast të ndeshjes së parregullsisë, duke përcaktuar edhe afatet përkatëse;
- masa ndëshkuese ndaj administratorëve që kanë të bëjnë me shkeljet e konstatuara ndaj kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Bankat, në mbështetje të kërkesave dhe të rekomandimeve të dhëna në raportet e ekzaminimit (në krahasim me vitin e kaluar) i kanë kushtuar kujdes plotësimi të akteve të brendshme të tyre në të gjitha fushat, e veçanërisht në veprimtarinë kredituese, në administrimin e rreziqeve të ndryshme etj.. Bankat po familjarizohen me nevojën e respektimit të ligjit, të akteve nënligjore dhe të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë. Këto krijojnë premisa, për zhvillimin e marrëdhënieve korrekte midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë.

"Manuali e veprimeve korrigjuese".

Hartimi i "Manualit të veprimeve korrigjuese" ka si qëllim kryesor përcaktimin e politikës së Bankës së Shqipërisë, për përdorimin e kompetencave në zbatimin e përgjegjësive të saj për marrjen e veprimeve korrigjuese, në përgjigje të shkeljeve nga bankat të ligjeve, të akteve nënligjore dhe/ose në rast se konstatohet ushtrimi i veprimtarisë të pasigurtë dhe të paqëndrueshme bankare.

Kjo politikë është përgatitur, për të përcaktuar veprimet në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, në rastet kur kjo e fundit e gjykon të nevojshme marrjen e tyre për zgjidhjen e çështjeve, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e sigurtë dhe të shëndoshë bankare ose me çështje të përputhjes me standardet e kësaj veprimtarie.

Në "Manualin e veprimeve korrigjuese" përcaktohen standardet për një veprimtari të sigurtë dhe të qëndrueshme bankare si dhe procedurat për arritjen e këtyre standardeve.

Banka e Shqipërisë ka autoritetin e vendosjes dhe të zbatimit të standardeve të një veprimtarie të sigurtë dhe të shëndoshë bankare, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e sistemit bankar. Kur Banka e Shqipërisë konstaton se në një bankë, ka probleme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e sigurtë dhe të qëndrueshme bankare ose të përputhjes me standardet e kësaj veprimtarie, ajo ndërhyr për marrjen e një veprimi korrigjues. Banka e Shqipërisë mund të përdorë një numër mjete për zbatimin e përgjegjësive të saj mbikëqyrëse sipas nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 8365, datë 2 korrik 1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Këto mjete fillojnë që nga këshillat apo rekomandimet (të cilat mund të jenë dhe në rastet kur nuk ka shkelje të akteve ligjore apo nënligjore, por thjesht inspektori vlerëson se rritet rreziku për bankën) memorandumet e mirëkuptimit, masat ndëshkimore dhe dënimet deri në nivele ekstreme.

Sipas këtij manuali, raporti i inspektimit i Bankës së Shqipërisë ose çdo mjet tjetër komunikimi me bankën, duhet të identifikojë dhe të përcjellë në mënyrë të qartë vlerësimin e gjendjes së bankës së inspektuar dhe të përshkruajë çdo problem, çështje, dobësi ose mangësi, duke dhënë gjithashtu edhe shkakun fillestar të çdonjërit prej tyre. Veprimi korrigjues i Bankës së Shqipërisë, duhet të ndikojë mbi dobësitë që në fazën e hershme të konstatimit të tyre, përpara se ato të kthehen në probleme shumë serioze. Veprimi korrigjues përgjithësisht përfshin premtimin e administratorëve ose angazhimet e këshillit drejtues, për zgjidhjen e problemeve të ngritura nga Banka e Shqipërisë. Kur banka fillon zbatimin e veprimeve për korrigjimin e problemeve të konstatuara dhe parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të situatës, Banka e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, inspektori apo analisti përkatës duhet të monitorojë përmesbushjen e tyre dhe të relatojë tek drejtuesit e departamentit.

4.3. Licencimi dhe rregullimet bankare

4.3.1. Licencimi.

Politika e Bankës së Shqipërisë lidhur me licencimin e bankave dhe të subjekteve të tjera, gjatë vitit 2002 në krahasim me një vit më parë, nuk ka ndryshuar. Kërkesat për kapitalin minimal të domosdoshëm janë ruajtur në të njëjtat nivele. Duke pasur si objektiv rritjen e transparencës së procesit të licencimit të bankave, Banka e Shqipërisë miratoi disa ndryshime në rregulloren “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë vitit 2002, ndryshe nga vitet e mëparshme, biznesi shqiptar është interesuar për hapjen e bankave private me kapital shqiptar.

Biznesi privat shqiptar, pas një periudhe 10-vjeçare, kaloi etapën fillestare të zhvillimit të vet, fitoi njëfarë pjekurie dhe tani ndihet më i sigurt në kryerjen e investimeve afatgjata.

Gjatë vitit 2002, pas tre vjetësh, kemi rritje të numrit të bankave. Këshilli Mbikëqyrës miratoi dhënien e licencës përfundimtare të Bankës së Kreditit të Shqipërisë, që shtoi në 14 numrin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri. Licenca paraprake për të kryer veprimtari bankare këtij subjekti iu dha me emrin “Banka Tregtare e Kuvaitit”, por gjatë periudhës së përgatitjes së bankës për marrjen e licencës përfundimtare, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të saj duke e konsideruar si të papërshtatshëm emrin e propozuar të bankës, mori vendimin për ndryshimin e tij në “Banka e Kreditit e Shqipërisë”, i miratuar paraprakisht nga Banka e Shqipërisë. Kjo bankë filloi aktivitetin e saj më 28 shkurt të vitit 2003.

Karakteristikë edhe për këtë vit është shtrirja e veprimtarisë së bankave ekzistuese në rrethe të tjera nëpërmjet hapjes së degëve e agjencive. Gjatë këtij viti janë hapur 9 degë të reja dhe 1 agjenci. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë ka pranuar hapjen edhe të degëve të tjera, por këto janë në fazën e përgatitjes së kushteve për fillimin e aktivitetit.

Banka e Shqipërisë shqyrton paraprakisht kërkesat e bankave për hapjen e degëve dhe të agjencive të reja dhe jep miratimin në heshtje ose refuzon zgjerimin e veprimtarisë së bankave, kur ky zgjerim kërcënon pozitën organizative, financiare dhe mbikëqyrjen e bankës apo strukturën e tregut, sipas parimit të konkurrencës.

Banka e Shqipërisë jep lejen për hapjen e degëve të bankave të licencuara jashtë vendit kur plotësohen disa kushte, që janë përcaktuar në rregulloren “Për dhënien e licencave për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë këtij viti u paraqit në Bankën e Shqipërisë kërkesa e Bankës së Kursimeve për hapjen e një dege të saj në Prishtinë. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë e miratoi këtë kërkesë.

Tabelë 2. Numri i bankave përbërëse të sistemit bankar.

<i>Ndarja sipas pronësisë</i>	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
G1 (banka shtetërore)	4 ¹³	3 ¹⁴	3	3	3	3	2 ¹⁵	2	1	1	1
G2 (banka të përbashkëta)		1 ¹⁶	2 ¹⁷	2	2	2	2	2	2	2	2
G3 (banka private)			1 ¹⁸	1	1	3 ¹⁹	6 ²⁰	9 ²¹	10 ²²	10	11 ²³
Numri bankave gjithsej	4	4	6	6	6	8	10	13	13	13	14²⁴

Tabelë: Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë

¹³ Në tregun bankar vepronin këto banka:

- Banka Kombëtare e Shqipërisë.
- Banka Shqiptare e Tregtisë.
- Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit.
- Banka e Kursimeve.

Banka e Shqipërisë, në dhjetor 1992, i jep licencën Bankës Arabo-Shqiptare Islamike, por kjo ka filluar aktivitetin bankar në vitin 1994.

¹⁴ Bankat shtetërore janë Banka Kombëtare Tregtare (e cila përfshin Bankën Kombëtare Shqiptare dhe Bankën Shqiptare të Tregtisë), Banka Tregtare Agrare (që u krijua me aktivet e mira të Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit, e cila pushoi së vepruari) dhe Banka e Kursimeve.

¹⁵ Mbyllet Banka Tregtare Agrare.

¹⁶ Fillon aktivitetin Banka Italo-Shqiptare.

¹⁷ Fillon aktivitetin Banka Arabo-Shqiptare Islamike.

¹⁸ Fillon aktivitetin Banka Dardania.

¹⁹ Fillojnë aktivitetin Banka Tirana dhe Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë.

²⁰ Fillojnë aktivitetin Banka Ndërkombëtare Tregtare, Dega e Bankës Alfa Kredit(Banka Alfa) dhe Banka Amerikane e Shqipërisë.

²¹ Fillojnë aktivitetin Banka FEFAD, Dega e Bankës së Parë të Investimeve-Tiranë dhe Banka Ndërtregtare (sot ka ndryshuar emrin Banka Tregtare e Greqisë (Shqipërisë)).

²² Banka Kombëtare Tregtare- privatizohet dhe pakësohet numri i bankave shtetërore dhe shtohet numri i bankave private.

²³ Shtuar Banka e Kreditit e Shqipërisë.

²⁴ Banka e Kreditit e Shqipërisë ka marrë licencën në gusht 2002, por aktivitetin bankar e ka filluar në shkurt të vitit 2003.

Nr.	Subjektet	Viti 1996	Viti 1997	Viti 1998	Viti 1999	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	6	8	10	13	13	13	14
2	Subjekte financiare jobanka				1	2	4	5
3	Zyra të këmbimit valutor				10	19	38	58
4	Shoqëri të kursim-kreditit							113
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit							2

Gjatë vitit 2002 është licencuar “Fondi i Financimit të Zonave Malore”, subjekt jobankë që ka si qëllim ushtrimin e veprimtarisë së kredithënies. Ndër subjektet financiare jobanka, shoqëria “Posta Shqiptare sh.a” ka zgjeruar veprimtarinë e saj me aktivitetin e shërbimit si agjente ose këshilltare financiare, si dhe është pajisur me licencën për kryerjen e aktivitetit të këmbimit valutor në disa rrethe të vendit.

Ligji “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, përcaktoi Bankën e Shqipërisë si autoritetin mbikëqyrës edhe të shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre. Mbi këtë bazë, Banka e Shqipërisë nxori aktet e brendshme rregullative lidhur me licencimin dhe mbikëqyrjen e këtyre subjeteve të mikrofinancës. Mbi bazën e rregullores “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” në bashkëpunim me Fondin e Financimit Rural dhe me fondacionin “Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kreditit” u licencuan 113 shoqëri të kursim-kreditit dhe 2 unione të shoqërive të kursim-kreditit.

Bankat dhe degët e bankave të huaja bëjnë ndryshimin e administratorëve dhe të aksionerëve të tyre vetëm pas marrjes së miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë ka dhënë miratimin paraprak për rreth 40 administratorë të rinj të bankave dhe të degëve të bankave të huaja, ku përfshihen anëtarë të këshillit drejtues, anëtarë të komitetit të kontrollit, drejtorë të përgjithshëm, drejtorë departamentesh dhe drejtuesit e degëve të bankave.

Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2002, në zbatim të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” miratoi paraprakisht pjesëmarrjen e Commerzbank AG, me 20 për qind të kapitalit të Bankës FEFAD.

4.3.2. Kuadri rregullator mbikëqyrës

Edhe gjatë vitit 2002 kuadri rregullator u plotësua me akte të reja rregullative të rëndësishme, që kishin të bënin me formalizimin dhe me rregullimin shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre, me kujdestarinë dhe likuidimin e bankave. Po gjatë vitit 2002, kuadri rregullativ ekzistues është përmirësuar me ndryshimin e disa rregulloreve për t’iu përshtatur ndryshimeve aktuale në tregun e produkteve dhe të shërbimeve bankare.

1. Krijimi i akteve rregullative të reja :

a) Rregullorja “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 27.02.02.

Licencimi i shoqërive të kursim-kreditit dhe i unioneve të tyre është një hap cilësor drejt kthimit të këtyre institucioneve të mikrofinancës në institucione formale të mbikëqyrura nga një autoritet përgjegjës si Banka e Shqipërisë.

Rregullorja “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” është rezultat i një pune disamujore të përbashkët të specialistëve të Bankës së Shqipërisë, ekspertëve shqiptarë dhe të huaj të Fondit të Zhvillimit Rural, të fondacionit “Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kreditit” dhe të ekspertëve të Bankës Botërore.

Formati i rregullores është i ngjashëm me formatin standard të disa dokumenteve të tjera të licencimit të Departamentit të Mbikëqyrjes për subjekte të tjera.

Në të janë të përcaktuara dokumentacioni i kërkesës për licencë, afatet dhe autoriteti i autorizuar për plotësimin e kërkesës për licencë. Në dallim nga dokumentet standarde të licencimit të përgatitura nga Departamenti i Mbikëqyrjes, rregullorja parashikon të drejtën e unionit të shoqërive të kursim-kreditit për të përfaqësuar shoqëritë e kursim-kreditit anëtare në union, në procesin e plotësimit të dokumentacionit të kërkesës për marrjen e licencës si dhe nëpërmjet dispozitave kalimtare, normohet dinamizmi që karakterizon procesin e krijimit të shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre.

b) Rregullorja “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 28.08.02.

Rregullorja “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” është dokumenti i dytë, i cili plotëson kuadrin rregullator mbikëqyrës për shoqëritë e kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre. Ndërsa me miratimin e rregullores “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” bëhet formalizimi i këtyre institucioneve në tregun financiar, me këtë projekt realizohet objektivi tjetër, ai i kthimit të tyre në institucione të rregulluara.

Rregullorja është hartuar në përputhje si me standardet e THE CONSULTATIVE GROUP TO ASSIST THE POOREST (CGAP) ashtu dhe me realitetin e mikrofinancës në vendin tonë.

Në këtë rregullore, përcaktohen mënyra e klasifikimit të kredive duke analizuar ditëvonesat dhe provigjoni i tyre, normat e mbikëqyrjes për cilësinë e portofolit të kredive, për mjaftueshmërinë e kapitalit, për likuiditetin, për shpërndarjen e rrezikut. Rregullorja është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë shqiptarë dhe të huaj të Fondit të Financimit Rural, të fondacionit “Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kreditit” nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të misionit dhe të ekspertëve të tjerë të Bankës Botërore.

c) Udhëzimi “Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 12.06.02.

Udhëzimi “Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave” nxirret në zbatim të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Procedurat që trajtohen në këtë

udhëzim kanë të bëjnë me situata në të cilat bankat, si rezultat i aktivitetit të tyre ose si rezultat i zhvillimeve jashtë tyre, përballen me probleme financiare, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje nga jashtë.

Në këtë udhëzim, procesi i kujdestarisë dhe i likuidimit është trajtuar në dy faza:

- Banka e Shqipërisë, në qoftë se shikon mundësinë e rehabilitimit të gjendjes financiare, vendos kujdestarinë;
- Banka e Shqipërisë, në qoftë se shikon se kujdestaria nuk jep rezultat, atëherë vendos revokimin e licencës dhe likuidimin e bankës.

Në këto kushte roli i mbikëqyrjes është:

- të sigurojë depozituesit që paratë e tyre në bankën e falimentuar do të trajtohen ndershmërisht;
- të ruajë besueshmërinë ndaj sistemit bankar në tërësi.

2. Përmirësimi i akteve rregullative ekzistuese :

- a) Një ndryshim në rregulloren “Për menaxhimin e riskut të kredisë”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 31, datë 08.05.02.

Ndryshimet e propozuara në rregulloren “Për menaxhimin e riskut të kredisë”, u diktuan nga eksperiencia praktike për përdorimin e kredisë kufi. Ato janë saktësime dhe plotësime në kuadrin rregullator për të rritur efektivitetin e mbikëqyrjes nga departamenti përkatës.

- b) Një ndryshim në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 11.09.02.

Në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”, në pjesën e përcaktimeve, është dhënë dhe lista e vendeve të zonës “A”. Nga kjo listë pas ndryshimit të bërë është hequr Turqia. Heqja e saj diktohet nga kushtet konkrete ekonomike dhe politike që po kalon. Këto kushte ndryshojnë shumë nga ato të një vendi të stabilizuar siç janë vendet e tjera të zonës “A”.

Miratimi i administratorëve të bankave

Gjatë vitit ka pasur ndryshime të shumta të administratorëve të bankave, të cilët miratohen në bazë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” nga Banka e Shqipërisë, përkatësisht Sektori i Licencimit dhe i Rregullimeve Bankare. Janë miratuar rreth 40 administratorë, të cilët janë evidentuar edhe në regjistrin e administratorëve të bankave dhe janë njoftuar edhe inspektorët për çdo ndryshim të kryer. Në këtë drejtim, është bashkëpunuar ngushtësisht me inspektorët e departamentit që mbulojnë bankat për rakordimin me regjistrin e administratorëve dhe theksimin e kërkesës së inspektorëve ndaj bankave për zbatimin e kërkesave të rregullores përkatëse.

Bankat janë treguar të kujdesshme në zbatim të kërkesave të rregullores për miratimin e administratorëve të tyre. Për çdo mangësi në dokumentacion,

bankat janë njoftuar nga Banka e Shqipërisë dhe pas plotësimit të të gjitha kërkesave të rregullores janë bërë miratimet përkatëse të administratorëve.

Miratimi i ekspertëve kontabël të autorizuar të bankave

Bankat, në bazë të nenit 40 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, kanë botuar bilancet kontabël dhe raportet vjetore të tyre. Kjo kërkesë e ligjit është edhe një detyrim i bankës për të qenë sa më transparente ndaj publikut dhe opinionit të gjerë. Botimi i këtyre materialeve i jep mundësi klientëve të njihen me gjendjen financiare të bankës ku kanë depozitat e tyre dhe inkurajon përsosjen e disiplinës në treg, pasi bankat kanë mundësi të njohin gjendjen e konkurrentëve të tyre dhe të reagojnë për probleme të caktuara.

Gjatë vitit që u mbyll është bërë një punë e kujdesshme nga ana e bankave në drejtim të plotësimit të kërkesave të udhëzimit “Për ekspertët kontabël të bankave”.

Raportet dhe opinionet e ekspertëve kontabël kanë ndihmuar bankat në zbatimin e parimeve dhe të standardeve të kontabilitetit. Gjatë vitit që shkoi nuk është konstatuar asnjë rast mashtrimi apo parregullsie materiale nga bankat. Megjithatë, ka patur rekomandime nga ekspertët kontabël për sistemime dhe rregullime në përputhje me standardet e kontabilitetit.

4.4. Plani afafmesëm i zhvillimit të Departamentit të Mbikëqyrjes

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore, ka hartuar një program për forcimin e aftësive mbikëqyrëse me efekt deri në vitin 2004. Zbatimi i këtij plani ka për qëllim rritjen e shkallës së sigurisë të sistemit bankar në Shqipëri nëpërmjet zbatimit me efikasitet të standardeve për një veprimtari bankare të shëndoshë dhe të sigurtë.

Për të realizuar këtë objektiv themelor u identifikuan nevojat në lidhje jo vetëm me përsosjen e dokumenteve bazë udhëheqëse dhe rregullative, mbi të cilat mbështetet mbikëqyrja, por edhe me zhvillimin dhe me përsosjen e mëtejshme të bazës rregullative për bankat e nivelit të dytë dhe të burimeve njerëzore brenda Departamentit të Mbikëqyrjes.

Në funksion të këtij qëllimi u përcaktuan disa detyra, një pjesë e të cilave kanë përfunduar ose janë në procesin e zbatimit dhe që kryesisht kanë të bëjnë me:

- Ripunimin e deklaratës së misionit të mbikëqyrjes me qëllim rritjen e transparencës dhe të përgjegjësisë në publik si edhe ndërgjegjësimin e publikut dhe të sistemit bankar me rolin e mbikëqyrjes bankare. Në këtë kuadër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr.37, datë 22.05.2002, ka miratuar Misionin e Mbikëqyrjes Bankare.

- Thellimin e auditimeve të kryera ndaj bankave nga ekspertët kontabël të pavarur dhe përsosjen e procesit të miratimit të tyre nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet disiplinimit të disa kritereve bashkëkohore në kuadrin rregullativ.

- Vlerësimin e cilësisë së punës që kryhet në lidhje me të gjithë ciklin e ekzaminimit të një banke dhe me kryerjen e përmirësimeve në bazë të konkluzioneve. Ky proces njihet me emrin Procesi i Sigurimit të Cilësisë.

Për zbatimin e kësaj detyre të planit të zhvillimit të mbikëqyrjes janë të angazhuara dy institucione, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia për Sigurimin e Depozitave. Midis tyre është nënshkruar dhe një Memorandum Mirëkuptimi, i cili angazhon palët në procesin e sigurimit të cilësisë, që synon të vlerësojë si nga pikëpamja cilësore ashtu dhe ajo sasiore, procesin e mbikëqyrjes së bankave.

- Përcaktimin e qartë të niveleve të vendimmarrjes nëpërmjet zhvillimit të një matrice duke filluar nga drejtuesit e departamentit, Zëvendësguvernatori i Parë, Guvernatori dhe Këshilli Mbikëqyrës.

Ky dokument i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr.59, datë 24 korrik 2002 ka si qëllim rritjen e nivelit të transparencës në mbikëqyrjen bankare, duke siguruar kështu që çdo hallkë e zinxhirit të hierarkisë të jetë e kujdesshme në zbatimin e të drejtave dhe detyrave të saj.

- Zhvillimin e një politike për të përcaktuar veprimet në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, në rastet kur kjo e fundit i gjykon ato të nevojshme për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e sigurtë dhe të shëndoshë bankare ose me çështje të përputhjes me standardet e kësaj veprimtarie.

Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë me vendim nr.51, datë 26 qershor 2002, ka miratuar "Manualin e masave korrektuese". Ky manual ka për qëllim veçimin e aktivitetit të bankave normale nga ato me probleme, në varësi të vlerësimit të gjendjes së përgjithshme financiare të tyre sipas sistemit CAMELS. Me qëllim përmirësimit të situatës, Banka e Shqipërisë mund të marrë disa masa. Këto masa kanë të bëjnë me lëshimin e rekomandimeve, të urdhrave, me nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit midis Bankës së Shqipërisë dhe bankës me probleme, me masat ndëshkimore ndaj administratorëve të bankës deri tek masa ekstreme e revokimit të licencës së bankës.

- Rritjen e bashkëpunimit me industrinë bankare brenda vendit dhe me autoritetet mbikëqyrëse të huaja nëpërmjet hapjes dhe ruajtjes së kanaleve të komunikimit.

Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë ka marrë takime me disa nga bankat e nivelit të dytë, duke synuar informimin në lidhje me problemet e ndryshme që shqetësojnë bankat, si edhe me problemet në nivel ekonomie, vlerësimin nga administrimi të anëve të forta të bankës dhe se çfarë do të dëshironte administrimi të shihte ndryshe në kuadrin e zhvillimit të bankës/aktivitetit dhe ekonomisë.

Gjithashtu, në këtë kuadër takime dypalëshe janë zhvilluar dhe me përfaqësues të Bankës Qendrore të Greqisë, të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe të Agjencisë së Rregullimit dhe Mbikëqyrjes Bankare të Turqisë.

- Zhvillimin e një baze të dhënash në formë elektronike për të gjitha bankat me qëllim ruajtjen e historisë së tyre dhe për të realizuar shmangien e një rreziku operacional brenda departamentit, marrjen e informacioneve në kohë dhe ruajtjen e vijueshmërisë së mbikëqyrjes për çdo bankë.

Së shpejti pritet të përfundojë puna mbi ngritjen e kësaj baze elektronike të dhënash, dhe më pas të merret dhe miratimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për shfrytëzimin e saj.

- Zhvillimin e burimeve njerëzore brenda departamentit nëpërmjet hartimit të një politike dhe vendosjes së disa procedurave, që do të identifikojnë kërkesat për trajnim të inspektorëve dhe përmbushjen në maksimum të tyre.

5. LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË

5.1. Banka dhe degë të bankave të huaja

1. BANKA ITALO - SHQIPTARE

Licenca Nr. 1/1996, datë 17.07.1998.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 89, datë 18.06.1998. Çertifikata nr. 1 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Adrian FULLANI

Adresa : Rruga "Barrikadave", Nr. 70, Tiranë.

Tel. central : 23 56 97, 23 56 98, 22 62 62.

Faks : 23 30 34.

2. BANKA E KURSIMEVE

Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998. Çertifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Ardian KAMBERI

Adresa : Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Nr.6, Tiranë.

Tel. central : 22 45 40, 22 26 69, 22 54 16.

Faks : 22 35 87, 22 36 95, 22 40 51.

3. BANKA ARABO-SHQIPTARE ISLAMIKE

Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998. Çertifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Abdul Waheed ALAVI

Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 8, Tiranë.

Tel. central : 22 84 60, 223 873, 227 408.

Faks : 228 460, 228 387.

4. BANKA DARDANIA

Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 01.12.1998. Çertifikata nr. 4 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Beqir MEZELXHIU

Adresa : Bulevardi "Zogu I" (pranë Fakultetit të Shkencave), Tiranë.

Tel. central : 22 87 59, 25 9350, 25 93 51.

Faks : 230-566.

Teleks : 2298 db banc ab

Email : db@albaniaonline.net ; dardaniabank@hotmail.com .

5. BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999. Çertifikata nr. 5 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Seyhan PENCAPLIGIL
Adresa : Bulevardi "Zhan Dark" Tiranë.
Tel: : 25 09 55.
Faks: : 25 09 56.

6. BANKA TIRANA

Licenca Nr. 07, datë 12.09.1996.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996. Çertifikata nr. 6 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Dimitris KARAVIAS
Adresa : Bulevardi "Zogu I", Nr. 55/1, Tiranë.
Tel. central : 233 441, 42, 43, 44, 45, 46,47.
Faks : 233 417.

7. DEGA E BANKËS KOMBËTARE GREKE TIRANË

Licenca Nr. 08, datë 25.11.1996.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, datë 14.03.1996. Çertifikata nr. 7 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Spiro BRUMBULLI
Adresa : Bulevardi "Zogu I", Nr. 72, Tiranë.
Tel. central : 233 621, 233 622, 233 623, 233 624.
Faks : 233 613.

8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE

Licenca Nr.09, datë 20.02.1997.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 30.04.1996. Çertifikata nr. 8 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Lee Chong Pa
Adresa : Rr. "Ded Gjon Luli", Tiranë.
Tel. central : 237 567, 237 568, 237 569.
Telfaks :237 570.

9. DEGA NË TIRANË E BANKËS ALPHA

Licenca Nr.10, datë 07.01.1998.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.01/03/96, datë 27.12.1997. Çertifikata nr. 9 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Andrea GALATOULAS
Adresa : Bulevardi "Zogu I", Nr.47, Tiranë.
Tel. : 233 532, 233 359, 340 476, 340 477.
Telfaks : 232 102.

10. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË

Licenca Nr.11, datë 10.08.1998.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998. Çertifikata nr. 10 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Lorenzo RONCARI

Adresa : Rruga "Ismail Qemali" Nr.27, P.O. Box 8319 – Tiranë.
Tel. : 348 753/4/5/6.
Telfaks : 348 762.

11. BANKA FEFAD SH.A.

Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 03.03.1999. Çertifikata nr. 11 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori : Jasper MENKEN
Adresa : Rruga "Sami Frashëri", Tirana e Re, P.O. Box. 2395, Tiranë.
Tel. : 230 499, 233 496.
Telfaks : 233 481.

12. DEGA NË TIRANË E BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SH.A.

Licenca Nr. 13, datë 16.04.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.45, datë 13.04.1999. Çertifikata nr. 12 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori : Petar Gavrillov KRASTEVI
Adresa : Bulevardi "Zogu I", Nr. 64, Tiranë.
Tel. : 356 423, 356 424.
Telfaks : 356 422.

13. BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) SH.A.

Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999. Çertifikata nr. 13 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori : George CARACOSTAS
Adresa : Rruga "Kavajës", "Tirana Tower", Tiranë.
Tel. : 587 55, 56, 57, 58, 59, 60.
Telfaks : 587 52.

14. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË Sh.A.

Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.66, datë 28.08.2002. Çertifikata nr. 14 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori : Kamal Adbel Maneim
Adresa : Rruga Perlat Rexhepi, Al-Kharafi Group Administration Building ,
Kati 1&2, Tiranë.
Tel. : 272 168; 272 162.
Telfaks : 272 162.
E-mail : creditbkalb@icc-al.org

15. BANKA "CREDINS" SH.A, TIRANË

Licenca nr. 16, datë 28.3.2003.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 26.03.2003. Çertifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori : Artan SANTO
Adresa : Rruga Ismail Qemali Nr.21 Tiranë.
Tel : 222916; 234096.

5.2.Subjekte jobanka

1. Unioni Financiar i Tiranës Sh.p.k. (UFT)

Licenca nr. 1, datë 08.12.1999 për të ushtruar veprimtaritë financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare;
- agjente apo këshilltare financiare .

Drejtor : Niko Leka
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Pall. Shallvareve, sh.2, n.18 Tiranë.
Tel : 250 653.

2. Diners Club Albania Sh.p.k.

Licenca nr. 2, datë 09.10.2000 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare .

Drejtor : Vebi Velia
Adresa : Rruga Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.

3.Posta Shqiptare Sh.a.

Licenca nr. 3, datë 18.04.2001 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Pronësia : Shtetërore
Drejtoresha : Aleksandra Çollaku
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku" , nr.4 Tiranë.

4. "CREDINS" Sh.a. Tiranë.

Licenca nr. 04, datë 13.06.2001 për të ushtruar veprimtaritë financiare:

- të dhënies kredi;
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të ofrimit të garancive;
- agjente ose këshilltare financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26 të ligjit: "Për bankat në Republikën e Shqipërisë").

Drejtoresha : Monika Milo

Adresa : Rruga "Ismail Qemali" Nr.21, Tiranë.
Tel : 222916; 234096.

5. "Fondi i Financimit të Zonave Malore".

Licenca nr. 5, datë 29. 03.2002 si subjekt financiar jobankë për të ushtruar veprimtarinë e mëposhtme:

- të japë kredi.

Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Drejtori : Arben Jorgji
Adresa : Rruga "Mustafa Matohiti" Vila nr.12, Tiranë.
Tel.: : 250633.

6. "ALBAKREDIT SH.p.k"

Licenca nr. 6 datë 18. 04.2003 si subjekt financiar jobankë për të ushtruar veprimtaritë e mëposhtme :

-të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat).

Administratori: Ermira Skënderi
Adresa : Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.5 Tiranë.
Tel.: 230 956.
Faks: 228 929.

Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: "Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"".

(Këto subjekte nuk licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, por kanë detyrimin të raportojnë në Bankën e Shqipërisë.)

1. Fondi i Financimit Rural.

- Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 28.04.1999.
- Objekti i veprimtarisë: Financimi i zonave rurale.
- Selia: Rr."Ismail Qemali", P. 32, Tiranë.
- Drejtor: Zana Konini.
- Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr.1843, datë 01.08.2000.

2. Fondacioni Besa.

- Themeluar nga "Fondi i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë" (SOROS).

- Objekti i veprimtarisë: Financimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.
- Selia: Rr."Asim Vokshi", Nr. 35, Tiranë.
- Drejtor: Bajram Muça
- Përrjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 2895/1, datë 19.01.2001.

3. Partneri Shqiptar për Mikroreditë.

- Aksioner: "Opportunity International"(East Europe).
- Objekti i veprimtarisë: Kredithënia.
- Adresa: Rr. "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë.
- Drejtor: James Reiff.
- Përrjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 828/1, datë 08.04.2002.

5.3. Zyra të këmbimeve valutore

1. Zyra e Këmbimeve Valutore “JOARD” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 1, datë 01.10.1999.

Adresa: Rruga “Ded Gjon Luli” Nr.2, Tiranë.

2. Zyra e Këmbimeve Valutore “AMA” Sh.p.k., Durrës

Licenca: Nr. 2, datë 01.10.1999.

Adresa: Rruga "Tregtare", Lagja 3, Durrës.

3. Zyra e Këmbimeve Valutore “ARIS” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 3, datë 01.10.1999.

Adresa: Rruga “Luigj Gurakuqi” , Tiranë.

4. Zyra e Këmbimeve Valutore “UNIONI FINANCIAR TIRANË” Sh.p.k.

Licenca: Nr. 4, datë 01.10.1999.

Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Pall. Shallvare, Shk. 2/18, Tiranë.

5. Zyra e Këmbimeve Valutore “AGLI” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 5, datë 01.10.1999.

Adresa: Agjencia 1: Rruga “Islam Alla” Nr.1, Tiranë.

Agjencia 2: Rruga "Kavajës", pranë pastiçeri "Rinia", Tiranë.

6. Zyra e Këmbimeve Valutore “ALBAKREDIT” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 06, datë 24.11.1999.

Adresa: Rruga “Ded Gjon Luli” Nr.5, Tiranë.

7. Zyra e Këmbimeve Valutore “GUDEN” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 07, datë 24.11.1999.

Adresa: Rruga “Konferenca e Pezës” , Tiranë.

8. Zyra e Këmbimeve Valutore “EXCHANGE” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 08, datë 24.11.1999.

Adresa: Rruga "Durrësit" Nr. 170 dhe “Reshit Çollaku” , Pall. Shallvare Shk. 4, Ap.42, Tiranë.

9. Zyra e Këmbimeve Valutore “UNISIX” Sh.p.k., Korçë

Licenca: Nr. 09, datë 26.11.1999.

Adresa: Bulevardi “Republika”, Pall.4, Korçë.

10. Zyra e Këmbimeve Valutore “EKSPRES J & E” Sh.P.K., Durrës

Licenca: Nr. 10, datë 26.11.1999.

Adresa: Lagja 11, Rruga “Prokop Mexsi” (pranë Hotel “Durrësi”), Durrës.

11. Zyra e Këmbimeve Valutore “MI & CO” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 11, datë 29.02.2000.

Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2/3, Tiranë.

12. Zyra e Këmbimeve Valutore "ILIRIA '98" Sh.p.k., TIRANË

Licenca: Nr. 12, datë 25.02.2000.

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Teatri i Kukullave, Tiranë.

13. Zyra e Këmbimeve Valutore "SERXHIO" Sh.p.k., Elbasan

Licenca: Nr. 14, datë 07.04.2000.

Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Rr."11 Nëntori", Pall. 70, Nr.14, Elbasan.

14. Zyra e Këmbimeve Valutore "ALBTUR" Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 15, datë 07.04.2000.

Adresa: Agjencia nr.1, Bulevardi "Zogu I", Pall. 32, Shk.1 (përballë Bankës Tirana), Tiranë.

15. Zyra e Këmbimeve Valutore "R & M" Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 16, datë 22.05.2000.

Adresa: Rruga "Punëtorët e Rilindjes", Pall. 182, Tiranë.

16. Zyra e Këmbimeve Valutore "TEUTA 2000" Sh.p.k., Durrës

Licenca: Nr. 17, datë 22.05.2000.

Adresa: Lagja 4, Rruga "Skënderbej", Ap. 950, Durrës.

17. Zyra e Këmbimeve Valutore "T & E" Sh.p.k., Durrës

Licenca: Nr. 18, datë 11.06.2000.

Adresa: Lagja 4, Rruga "9 Maji", Durrës.

18. Zyra e Këmbimeve Valutore "SHIJAK 2000" Sh.p.k., Shijak

Licenca: Nr. 19, datë 24.11.2000.

Adresa: Lagja "Popullore", Shijak.

19. Zyra e Këmbimeve Valutore "R & T" Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 20, datë 20.12.2000.

Adresa: Bulevardi "Zogu I", (pranë BPI-së), Tiranë.

20. Zyra e Këmbimeve Valutore "DV-ALBA" Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 21, datë 11.01.2001.

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Tirana Internacional Hotel, Tiranë.

21. Zyra e Këmbimeve Valutore "MANUSHI" Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 22, datë 18.04.2001.

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.

22. Zyra e Këmbimeve Valutore "UNIONI SELVIA" Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 23, datë 21.05.2001.

Adresa: Në krah të Postës Qendrore, godina 2-katëshe, kati I, Tiranë.

23. Zyra e Këmbimeve Valutore “KALENJA” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 24, datë 29.06.2001.

Adresa: Rruga “Kavajës” (pranë Ambasadës Turke), Tiranë.

24. Zyra e Këmbimeve Valutore “TILBA” Sh.p.k., Elbasan

Licenca: Nr. 25, datë 30.09.2001.

Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Qemal Stafa", Njësia nr.12, Elbasan.

25. Zyra e Këmbimeve Valutore “ANAGNOSTI” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 26, datë 31.10.2001.

Adresa: Zyra 1- Bulevardi “Zogu I”, Pallati 97, shk.3.ap. 28, Tiranë.
Zyra 2- Rruga “Kajo Karafili”, nr.11 Tiranë.

26. Zyra e Këmbimeve Valutore “KO-GO” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 27, datë 12.11.2001.

Adresa: Rruga “Vaso Pasha”, Pall.16, Shk.2, Ap. 9, Tiranë.

27. Zyra e Këmbimeve Valutore “ALB- FOREX” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 28, datë 22.11.2001.

Adresa: Agjencia 1- Rruga “Abdyl Frashëri Nr.3, Tiranë.
Agjencia 2- Rruga “Mine Peza”, Pall. 102, Shk.1 (pranë Bar Grand), Tiranë.

28. Zyra e Këmbimeve Valutore “L&N” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 29, datë 22.11.2001.

Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësia”, ish-Gjelltorja tek sheshi ATATURK, Tiranë.

29. Zyra e Këmbimeve Valutore “TERBACI- GJ” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 30, datë 22.11.2001.

Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësia”, Pall.215, Kati I(dyqanet), Tiranë.

30. Zyra e Këmbimeve Valutore “EXCHANGE ALOG” Sh.p.k., Tiranë

Licenca: Nr. 31, datë 22.11.2001.

Adresa: Rruga “Mine Peza” (përballë selisë së Vatikanit), Tiranë.

31. Zyra e Këmbimeve Valutore “EX-CHANGE BEBI&FLORI” Sh.p.k., FIER

Licenca: Nr. 32, datë 26.11.2001.

Adresa: Lagja "Kongresi i Përmetit", Fier.

32. Zyra e Këmbimeve Valutore “GERSILDA” Sh.p.k., TIRANË

Licenca: Nr. 33, datë 03.12.2001.

Adresa: Lagja nr.2, Rr. “Mihal Grameno”, Pall.10, dyqani nr.5, Tiranë.

33. Zyra e Këmbimeve Valutore “CHANGE-ARIZAJ” Sh.p.k., TIRANË

Licenca: Nr. 34, datë 03.12.2001.

Adresa: Rr. "Pandi Madhi", Pall.60/2, Ap.15, Tiranë.

34. Zyra e Këmbimeve Valutore “BASHKIMI 2001” Sh.p.k., TIRANË

Licenca: Nr. 35, datë 12.12.2001.

Adresa: Rr. "Kavajës" (pastiçeri “Rinia”), Tiranë.

35. Zyra e Këmbimeve Valutore “ARJON 2002” Sh.p.k.

Licenca: Nr. 36, datë 14.12.2001.

Adresa: Lagja “Kongresi i Elbasanit”, Bulevardi“Qemal Stafa”, Pall.9-katësh, Elbasan.

36. Zyra e Këmbimeve Valutore “Euro 2002” Sh.p.k. Durrës

Licenca: Nr. 39, datë 21.12.2001.

Adresa: Lagja nr.11, Rr. “Ismail Qemali”, pranë PTT, Durrës.

37. Zyra e Këmbimeve Valutore “Euro Travels International”Sh.p.k. Tiranë

Licenca Nr. 40, datë 14.01.2002.

Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, pallatet Agimi Nr.1, Tiranë.

38. Zyra e Këmbimeve Valutore “G&3” Sh.p.k. Kavajë,

Licenca Nr. 41, datë 15.01.2002.

Adresa: Rruga”Kajo Karafili”, Kavajë.

39. Zyra e Këmbimeve Valutore “ALAKTH” Sh.p.k. Tiranë

Licenca Nr. 42, datë 18.01.2002.

Adresa: Rruga e Dibrës,nr.105/1, Tiranë.

40. Zyra e Këmbimeve Valutore “Format” Sh.p.k. Tiranë

Licenca Nr. 43, datë 21.01.2002.

Adresa: Rruga e Durrësit, Pall.85, shk.1,ap.1, Tiranë.

41. Zyra e Këmbimeve Valutore “TRI URAT” Sh.p.k. Elbasan

Licenca Nr. 44, datë 05.02.2002.

Adresa: Lagja “29 nëntori”, pranë filialit të postës Elbasan.

42. Zyra e Këmbimeve Valutore “CROWNTOWN” Sh.p.k. Tiranë

Licenca Nr. 45, datë 05.02.2002.

Adresa: Rruga “Mihal Grameno”, Pall 10,Tiranë.

43. Zyra e Këmbimeve Valutore “BESA 2001” Sh.p.k. Tiranë

Licenca Nr. 46, datë 15.02.2002.

Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Nr.25,Tiranë.

44. Zyra e Këmbimeve Valutore "MARIO" Sh.p.k. Sarandë

Licenca Nr. 47, datë 14.03.2002.

Adresa: Lagja 1, pranë ish-Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.

45. Zyra e Këmbimeve Valutore "JAV" Sh.p.k. Tiranë

Licenca Nr. 48, datë 20.03.2002.

Adresa: Bulevardi "Zogu I" Godina e "Zërit të Popullit" Tiranë.

46. Zyra e Këmbimeve Valutore "DROGU" Sh.p.k. Tiranë

Licenca Nr. 49, datë 23.04.2002.

Adresa: Rruga "Vaso Pasha" Kulla 1, Kati I (pas pallatit Agimi) Tiranë.

47. Zyra e Këmbimeve Valutore "HYSEN-C" Sh.p.k. Laç

Licenca Nr. 50, datë 23.04.2002.

Adresa: Lagja nr.3, përballë Komisarariatit të Policisë, Laç.

48. Zyra e Këmbimeve Valutore "UNIONI FIER" Sh.p.k. Fier

Licenca Nr. 51, datë 08.05.2002.

Adresa: Lagja "15 Tetori", Rruga "Kastriot Muça", Fier.

49. Zyra e Këmbimeve Valutore "TAXI EKSPRES" Sh.p.k. Elbasan

Licenca Nr. 52, datë 20.05.2002.

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr.11 (pranë Shkollës "Edit Durhan").

50. Zyra e Këmbimeve Valutore "MERO" Sh.p.k. Devoll

Licenca Nr. 53, datë 22.05.2002.

Adresa: Zyra nr.1 : Bulevardi "Fuat Babani", Bilisht.

Zyra nr.2 : Dogana Kapshticë.

51. Zyra e Këmbimeve Valutore "GLEAR" Sh.p.k. Shijak

Licenca Nr. 55, datë 23.07.2002.

Adresa: Lagja Kodër Shijak Durrës.

52. Zyra e Këmbimeve Valutore "POSTA SHQIPTARE" Sha. Tiranë,

Licenca Nr. 56, datë 28.08.2002.

Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", nr.4 Tiranë.

53. Zyra e Këmbimeve Valutore "Unioni Ballsh" Sh.p.k. Ballsh

Licenca Nr. 57, datë 11.09.2002.

Adresa: Rruga "8 Nëntori", Ballsh.

54. Zyra e Këmbimeve Valutore "ESLULI" Sh.p.k. Tiranë

Licenca: Nr. 58, datë 17.10.2002.

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Pallati i Shallvareve, shkalla n.4/1.

**55. Zyra e Këmbimeve Valutore “AMERICAN GLOBAL CAPITAL FUND-
WORLDWIDE INVESTMENT” Sh.p.k. Tiranë**

Licenca: Nr. 59, datë 26.11.2002.

Përfaqësues me prokurë : Dashor Shehaj, Vilson Ahmeti.

Adresa: Rr. “Ismail Qemali”, Parcela 167/187 “Euroapartment”, Tiranë.

UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

1. Unioni i shoqërive të kursim-kreditit “JEHONA” Tiranë

Licenca: Nr.1, datë 27.06.2002.

Kryetar i bordit drejtues : Vojsava Rama

Anëtare të këtij unioni janë 41 shoqëri të kursim-kredive, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga fondacioni “Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kredive”.

**2. Unioni i shoqërive të kursim-kreditit “UNIONI SHQIPTAR KURSIM-
KREDITIT” Tiranë**

Licenca: Nr.2, datë 09.08.2002.

Adresa: Rruga “Ismail Qemali”, nr.32.

Kryetar i bordit drejtues : Zana Konini

Tel. 25 19 10

E-mail : ffrural@albaniaonline.net

Anëtare të këtij unioni janë 71 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga Fondi i Financimit Rural.

3. SHOQËRIA E KURSIM-KREDITIT “INBLEG” Tiranë

Licenca: Nr.70, datë 25. 09.2002.

6. LISTA E RREGULLOREVE TË MBIKËQYRJES BANKARE NË FUQI DERI NË QERSHOR TË VITIT 2003

1- Rregullorja “**Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 71, datë 11.09.2002.

2- Rregullorja “**Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 17.02.1999 dhe një ndryshim i kësaj rregulloreje me vendimin nr.17, datë 01.03.2000.

3- Rregullorja “**Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 18.03.1999.

4- Rregullorja “**Për menaxhimin e riskut të kredisë**” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12 datë 21.02.2001, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 08.05.2002.

5- Rregullorja “**Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal, për veprimtarinë e lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 22.04.1999.

6- Udhëzimi “**Për kapitalin rregullator**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.40, datë 16.05.2001.

7- Rregullorja “**Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.86, datë 07.11.2001, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.72, datë 11.09. 2002, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.30, datë 16.04.2003.

8- Rregullorja “**Për pozicionet e hapura valutore**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 118, datë 01.12.1999.

9- Rregullorja “**Për veprimtarinë valutore**”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 21.02.2001.

10- Udhëzimi **“Për likuiditetin e bankave”**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 19.01.2000, ndryshuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2003.

11- Rregullorja **“Për risqet e tregut”**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 02.06.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 98, datë 19.12.2001.

12- Rregullorja **“Për kontrollin e risqeve të mëdha”**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 07.07.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 119, datë 01.12.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.92, datë 05.12.2001.

13- Udhëzimi **“Për kontrollin e brendshëm në banka”**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 107, datë 03.11.1999.

14- Rregullorja **“Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare”** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.42, datë 06.06.2001.

15- Rregullore **“Për bankat kooperative”** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 29.03.2000.

16- Udhëzim **“Mbi menaxhimin e rrezikut të normës së interesit”**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.61, datë 05.07.2000.

17- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.26, datë 29.03.2000 **“Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë””**.

18- Rregullorja **“Për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 06, datë 05.07.2000.

19. Rregullore **“Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave”** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.06, datë 29.01.2003.

20. Sistemi i raportimit të shoqërive të kursim-kredive , miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.75, datë 05.09.2001.

21.Udhëzimi **“Për çertifikatat e depozitave”**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 03.10.2001.

22.Udhëzim **“Për parandalimin e pastrimit të parave”** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.102, datë 29.12.2001.

23. Rregullorja “**Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit**” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 27.02.2002, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 09, datë 12.02.2003.

24. Udhëzimi “**Për kujdestarinë dhe likuidimin e bankave**” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.45, datë 12.06.2002.

25. Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 58, datë 24.07.2002 miraton shtimin në veprimtaritë e lejuara të bankave të “**veprimtarisë bankare lidhur me arin dhe metalet e çmuara**”.

26. Rregullorja “**Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit**” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 28.08.2002, ndryshuar me vendimin e ndimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 13.11.2002.